

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

SEKTORI I ÇËSHTJEVE SHOQËRORE

TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Analizë e faktorëve të riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve

Punuan: Ani Beqo

Blerta Doçi

Ndihmoi me përpunimin e të dhënave të pyetsorëve Xhiliola Nikolla.

Tiranë, Nëntor 2015

ABSTRAKT

Studimi i kriminalitetit të të miturve në Shqipëri, fokusuar kryesisht në faktorët psiko-socialë që ndikojnë në nxitjen e fenomenit në fjalë, është një përpjekje për të analizuar në disa dimensione situatën aktuale të të miturve në konflikt me ligjin.

Nëpërmjet këtij punimi synohet të prezantohen profilet e të miturve në Institucionet e Ekzekutimit të Vuajtjes së Dënimit në vend, bazuar në përpunimin dhe analizimin e statistikave dhe të dhënave të tjera ekzistuese, si dhe në intervista të kryera me të miturit në konflikt me ligjin, qofshin këta të paraburgosur, apo të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykatat.

Qëllimi kryesor i punës së kryer në këtë drejtim është identifikimi dhe analizimi i faktorëve që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo indirekte në përfshirjen e të miturve në kryerjen e veprave penale, me qëllim krijimin e një tabloje të qartë të kriminalitetit të të miturve në vend dhe sugjerimin e masave parandaluese.

Për të grumbulluar një pjesë të të dhënave janë shfrytëzuar disa burime institucionale siç janë ato të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale ku janë akomoduar të miturit. Po ashtu janë zhvilluar vëzhgime, pyetësorë, si dhe intervista me të miturit dhe stafin social në institucionet penitenciare.

Pjesa tjetër e të dhënave janë siguruar përmes literaturës së përdorur në funksion të mbështetjes së ideve, analizave dhe sugjerimeve të prezantuara në studim. Në këtë kontekst janë shfrytëzuar botime të cilat hedhin dritë mbi profilin e të miturve në konflikt me ligjin dhe faktorët individualë dhe komunitarë që nxisin kriminalitetin, si dhe japin ide mbi masat më efektive për parandalimin dhe reduktimin e fenomenit.

Si i tillë, ky punim përbën një tekst që u vjen në ndihmë profesionistëve të fushës, por dhe strukturave dhe subjekteve të interesuara për të njohur më shumë mbi këtë target-grup.

PËRMBAJTJA

Lista e tabelave dhe grafikëve	4
Hyrja.....	5
Metodologjia.....	6
Kreu 1. Kriminaliteti i të miturve i parë në këndvështrimin psiko-social.....	9
1.1 Çështje të përgjithshme.....	9
1.2 Disa koncepte mbi kriminalitetin e të miturve.....	10
Kreu 2. Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri.....	11
2.1 Situata e kriminalitetit të të miturve.....	11
Kreu 3. Faktorët e riskut për kriminalitetin e të miturve.....	15
3.1 Vështrim i përgjithshëm mbi faktorët e riskut	15
3.2 Faktorët individualë të riskut.....	16
Kreu 4. Profili i të miturve në konflikt me ligjin.....	29
4.1 Vështrim i përgjithshëm i profilit të të miturve në konflikt me ligjin.....	29
4.2 Profili i të miturve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale	30
Kreu 5. Parandalimi dhe ndërhyrja.....	35
5.1 Modelet e suksesshme të parandalimit të kriminalitetit të të miturve.....	35
5.2 Rehabilitimi i të miturve në institucionet e vuajtjes së dënimit.....	38
Rezultatet e studimit.....	45
Përfundime dhe propozime.....	46
Bibliografia.....	49

Lista e tabelave dhe grafikëve

Tabela:

- Tabela 1. Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur/ me seksion për të mitur në Shqipëri.
- Tabela 2. Të mitur të paraburgosur dhe dënuar për vepra penale në Shqipëri sipas grupmoshës 2007-2015,.
- Tabela 3. Vendbanimet e të miturve në konflikt me ligjin sipas qyteteve.
- Tabela 4. Lloji i krimeve të kryera nga të miturit, 2007-2015.
- Tabela 5. Indikatorët e faktorëve të riskut tek të miturit
- Tabela 6. Tregues rreth ambientit familjar që i përkasin të miturve në IEVP.
- Tabela 7. Faktorë të riskut që lidhen me bashkëmoshatarët dhe stilin e jetesës.
- Tabela 8. Faktorë të tjerë risku që lidhen me shkollimin/punësimin e të miturve.
- Tabela 9. Faktorët e riskut në komunitet.
- Tabela 10. Kontaktet e të miturve në IEVP me prindërit dhe anëtarë të familjes
- Tabela 11. Faktorë risku që lidhen me përdorimin e drogave
- Tabela 12. Perceptimi i vetes dhe të tjerëve nga të miturit
- Tabela 13. Mënyra e të menduarit dhe sjelljet e të miturve
- Tabela 14. Qëndrimet ndaj veprës/ave penale
- Tabela 15. Plani i trajtimit për të miturit në I.E.V.Penale.
- Tabela 16. Numri i të miturve në I.E.V.Penale, Nëntor 2015

Grafikë:

- Grafiku 1. Karakteristikat e viktimave të veprave penale të kryera nga të miturit.
- Grafiku 2. Përsëritja e krimeve nga të miturit (Recidivizmi).
- Grafiku 3. Tregues të ambientit familjar të të miturve në IEVP.
- Grafiku 4. Niveli arsimor i përfunduar nga të miturit në IEVP.
- Grafiku 5. Arsyet e evidentuara nga të miturit për ndërprerjen e shkollimit.
- Grafiku 6. Vendbanimi i të miturve që ndodhen në IEVP

Hyrja

Përfshirja e të miturve në akte kriminale është një fenomen i njohur për shoqërinë shqiptare, sidomos në vitet e fundit. Ky punim synon të prezantojë situatën e të miturve në konflikt me ligjin, duke u përqëndruar kryesisht në faktorët që përbëjnë risk për përfshirjen e të miturve në sjellje kriminale.

Në këtë kontekst, target-grup i synuar janë të miturit në konflikt me ligjin në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Studimet e kryera në këtë fushë kanë treguar se sjellja delinkuente e të miturve gjenerohet nga ndërveprimi i faktorëve të ndryshëm në planin individual, familjar dhe social, të konsideruar si faktorë risku. Me anë të intervistave të realizuara me të miturit është synuar krahasimi i literaturës apo studimeve të realizuara në këtë fushë mbi faktorët riskut që shtojnë të miturit të përfshihen në sjellje delinkuente, me profilet ekzistuese të të miturve në konflikt me ligjin në Shqipëri.

Rëndësia e studimit qëndron në evidentimin e faktorëve të konsideruar me risk, profilet dhe karakteristikat e tyre, si dhe konsiderimin e alternativave apo masave parandaluese për reduktimin e këtij fenomeni.

Synimi final i studimit është të rifreskojë konceptet dhe të dhënat ekzistuese në këtë fushë, si dhe të azhurnojë srukturat dhe subjektet e interesuara në trajtimin sa më të përshtatshëm të kësaj kategorie.

Metodologjia

Qëllimi i studimit

Ky studim përqipet të shqyrtojë faktorët e riskut të kriminalitetin tek të miturit, mbështetur në të dhënat e të miturve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Shqipëri gjatë periudhës 2007-2015.

Së pari studimi përqipet të japë një tablo të qartë të krimeve të kryera nga të miturit, sipas statistikave që disponojnë strukturat shtetërore të publikuara në studime dhe raporte mbi situatën e të miturve në konflikt me ligjin.

Së dyti përmes shqyrtimit të literaturës së fushës, intervistave të kryera me të mitur të akuzuar apo dënuar për kryerjen e veprave penale, studimit të rasteve në terren dhe intervistave të realizuara me stafin e kujdesit social dhe atë të sigurisë në burgje dhe paraburgime, ky studim përqipet të hedhë dritë mbi faktorët psiko-socialë që ndikojnë më së shumti në përfshirjen e të miturve në vepra penale.

Së treti, studimi parashtron disa strategji parandalimi si dhe pasqyron punën që realizohet aktualisht në burgje dhe paraburgime për rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.

Kampioni

Kampion i përzgjedhur për realizimin e studimit janë 78 të mitur në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Të miturit në konflikt e ligjin në periudhën e intervistimit ishin të gjithë meshkuj.

Tabela 1. Numri i të miturve në I.E.V.Penale, Nëntor 2015

Institucioni	Të paraburgosur	Të dënuar
Kavajë	20	20
Vlorë	18	-
Korça	3	-
Lezhë	17	-

Instrumentat

Për të grumbulluar të dhënat janë shfrytëzuar disa burime institucionale të cilat kanë vënë në dispozicion statistika mbi kriminalitetin e të miturve. Përveç sa më sipër,

janë zhvilluar *intervista* dhe një *pyetësor*. Kombinimi i instrumentave të ndryshëm (sasiorë dhe cilësorë) është bërë për të kompesuar disavantazhet e secilit instrument të përdorur më vete.

Procedurat

Fillimisht institucionet përkatese u informuan në lidhje me qëllimin dhe procedurat e këtij punimi dhe prej tyre u mor autorizimi për realizimin e tij. Po ashtu mbi qëllimet e punimit u informuan edhe të miturit në konflikt me ligjin, të cilët pranuan të përfshiheshin në studim.

Pyetësori nuk ishte i vetëadministrueshem dhe kërkohej mesatarisht 15 minuta kohë për plotësimin e tij. Për plotësimin e pyetësorit të miturit u intervistuaan dhe asistuan nga specialistët e sektorëve të çështjeve sociale në 4 IEVP ku ata ndodhen të akomoduar. Përpara plotësimit pjesëmarrësve i'u dhanë sqarimet e duhura mbi qëllimin e punimit dhe konfidencialitetin e të dhënave identifikuese. Të miturve që pranuan vullnetarisht të kontribuojnë për realizimin e punimit, i'u siguruar konfidencialiteti dhe anonimiteti në lidhje me përgjigjet e dhëna. Pyetësori u plotësua gjatë muajit Nëntor 2014 në 4 institucionet penitenciare ku gjenden të akomoduar të miturit. Po gjatë kësaj periudhe u kontaktua dhe me stafin e institucioneve në fjalë të cilët përmes ofrimit të të dhënave mbi punën e zhvilluar në këto institucione dhanë një kontribut të konsiderueshëm për realizimin e studimit.

Variablat

Variabla të tillë si gjendja e vështirë ekonomike, problematikat në familje, mosarsimimi i vetë subjekteve, toksikomania, recidivizmi dhe variabla demografikë të tillë si mosha, gjinia dhe vendbanimi janë konsideruar si variabla të pavarur. Përfshirja në sjellje kriminale është konsideruar si variabël i varur.

Kufizimet e studimit, besueshmëria dhe vlefshmëria

Për të garantuar besueshmërinë e punimit, të dhënat e siguruar nga administrimi i pyetësorit janë karahasuar dhe me të dhëna të disponuara nga institucionet.

Përsa i përket vlefshmërisë së punimit, rezultoi se prezenca dhe ndikimi i faktorëve të riskut të të miturit në konflikt me ligjin, mbështetej prej të dhënave të përftuara, si dhe faktit që rezultatet mund të përgjithësoheshin.

Pavarësisht nga përpjekjet për të realizuar këtë studim modest, duhet përmendur që pavarësisht se informacionet e parashtruara janë në përputhje me evidencat e vetë institucioneve penitenciare, analizimi i faktorëve të riskut për efekt kohe është realizuar duke u bazuar vetëm në pohimet dhe opinionet e të miturve.

Mungojnë statistikak që krahasojnë kriminalitetin e të miturve me kriminalitetin e të rriturve. Krahasimi i këtyre të dhënave do të na ndihmonte për krijimin e një kuadri më të plotë mbi fenomenin.

Çështje etike

Siç është përmendur dhe më lart, për realizimin e punimit u morën parasysh disa çështje të lidhura me etikën si:

- Informimi i institucioneve penitenciare në lidhje me qëllimin dhe procedurat punimit dhe marrja e një autorizimi për realizimin e tij.
- Informimi i të miturve në konflikt me ligjin mbi arsyet e studimit.
- Dhënia e sqarimeve të duhura pjesëmarrësve mbi qëllimin e punimit dhe konfidencialitetin e të dhënave identifikuese.
- Ruajtja e anonimatit dhe konfidencialitetit të të dhënave të siguruar nga evidencat e institucioneve, përgjigjet e pyetësorit dhe studimet e rastit.
- Së fundi gjatë realizimit të punimit janë marrë të gjitha masat e nevojshme për respektimin e dinjitetit, të pjesëmarrësve.

Shqyrtimi i literaturës

Për realizimin e punimit është përdorur literaturë e studiuesve vendas dhe të huaj në funksion të analizave, konkluzioneve dhe rekomandimeve të dhëna.

Në bazë shqyrtimit të literaturës mbi studime të fushës janë trajtuar çështje si:

1. Koncepte mbi kriminalitetin e të miturve sipas legjislacionit shqiptar.
2. Faktorët e riskut që ndikojnë në rritjen e kriminalitetit të të miturve.
3. Teori të ndryshme mbi profilin e të miturve në konflikt me ligjin.
4. Modelet e suksesshme të parandalimit të kriminalitetit të të miturve.
5. Modeli konceptual i programit për zëvendësimin e agresivitetit (ART), që përdoret në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Për më tepër punimi ka sjellë disa të dhëna statistikore të publikuara nga struktura shtetërore, studime, apo raporte të mëparshme mbi kriminalitetin e të miturve.

Kreu 1

Kriminaliteti i të miturve i parë në këndvështrimin psiko-social.

1.1 Çështje të përgjithshme

Ky punim fokusohet në krijimin e një kuadri të plotë të kriminalitetit të të miturve duke pasur në qendër të vëmendjes faktorët që nxisin kriminalitetin (faktorët e riskut) dhe karakteristikat e personave që rrezikohen të përfshihen në akte të cilësuar si vepra penale.

Në këtë kuadër, është me rëndësi të sqarohen fillimisht kufijtë moshorë për të miturit e përfshirë në aktivitete kriminale me qëllim evidentimin dhe përcaktimin e grupit të synuar bazuar në legjislacionin shqiptar.

Konkretisht, referuar legjislacionit “fëmijë”, apo “i mitur” konsiderohet personi nën moshën 18 vjeç. Personat nën këtë moshë grupohen në:

- a. Persona nën moshën 14 vjeç.
- b. Persona 14-18 vjeç.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, kufiri minimal për të pasur përgjegjësi penale është 14 vjeç. Për personat e moshës 14-18 vjeç ligji penal përdor termin “i mitur”¹.

Studimet e realizuara në këtë drejtim tregojnë se sjellja delinkuente te të miturit gjenerohet nga faktorë psiko-socialë të riskut, të cilët ndërveprojnë midis tyre. Për këtë arsye për studimin e kriminalitetit te të miturit duhet të konsiderohen të gjitha faktorët dhe dimensionet në të cilat ato ndikojnë.

E thënë ndryshe, përfshirja e të miturve në aktivitete të jashtëligjshme gjendet e lidhur me faktorë specifikë personalë, familjarë dhe shoqërorë, të cilët duhen shqyrtuar në raport me njëri-tjetrin.

Nga studimet paraardhëse, evidencat ekzistuese dhe intervistat e realizuara me të miturit në konflikt me ligjin rezulton se një pjesë e tyre vijnë nga familje problematike, me histori divorci, dhune, pa njërin prind, apo prindër në emigracion.

¹ Hysi, V., Cikël leksionesh, Tiranë, 2000.

Përsa i përket aspektit gjeografik, duket se kriminaliteti haset më shpesh tek të miturit që jetojnë në mjedise heterogjene, sidomos te të ardhurit rishtaz nga zonat rurale në zonat urbane.

Një aspekt tjetër me rëndësi është roli i arsimit. Një pjesë e të miturve në konflikt me ligjin nuk kanë kryer arsimin e detyruar pasi për arsye të ndryshme, socio-ekonomike janë detyruar ta ndërpresin ciklin e shkollimit.

1.2 Disa koncepte mbi kriminalitetin e të miturve

Nuk ekziston një përkufizim i pranuar në mënyrë konsesuale për sjelljen delinkuente të të miturve. Disa autorë e përkufizojnë delinkuencën si sjellje jo e ekuilibruar emocionalisht, të tjerë si sjellje antisociale e vazhdueshme, apo sjellje të përcaktuar si devijante nga autoritetet.

Pavarësisht nga sa më sipër, delinkuenca e të miturve dhe të rinjve është një status që përcaktohet nga gjykata mbi bazën e legjislacioni vendas, mbështetur në provat dhe të dhënat e grumbulluara².

Sjelljet delinkuente të të miturve kanë dy dimensione të ndërthurura: të miturit si autorë të veprave penale dhe të miturit si të dëmtuar prej veprave penale. Nga studime të kryera në Shqipëri mbi të dhënat për kriminalitetin e të miturve, rezulton se krahas autorëve të veprave penale një numër i konsiderueshëm të miturish janë viktimat e këtyre veprave me autorë bashkëmoshatarët e tyre³.

² Newman, D.J., and Anderson P.R., "Introduction to Criminal Justice", New York, 1990.

³ Kriminaliteti i të Miturve në Shqipëri, përgatitur nga Qendra për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), Tiranë, 2007.

Kreu 2

Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri

2.1 Situata e kriminalitetit të të miturve

Legjislacioni shqiptar përcakton se të miturit me masë sigurie arrest me burg dhe ata që marrin vendimin e formës së prerë nga gjykatat akomodohen në institucione për të mitur, ose në institucione me seksione të veçanta për të mitur.

Sipas të dhënave të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për periudhën 2007-2015 rezulton se numri i të miturve në konflikt me ligjin ka qënë përgjithësisht në rritje, përveç uljeve në vitet 2011 dhe 2013.

Tabela 3. Të mitur të paraburgosur dhe të dënuar sipas grupmoshave, 2007-2015.

Viti \ Moshë	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
14	5	5	3	3	5	11	13	4	11
15	13	30	34	32	23	42	33	23	18
16	35	46	58	75	67	79	67	62	43
17 deri në 18	73	67	63	100	81	100	86	112	132
Totali	124	148	158	210	176	232	199	201	204

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Ndërkohë sipas të dhënave të IEVP-ve rezulton se kriminaliteti i të miturve është shumë më i lartë në zonat urbane me popullsi heterogjene si Tirana apo Durrësi.

Tabela 4. Vendbanimet e të miturve në konflikt me ligjin, sipas qyteteve

Vendbanimet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Malësi e Madhe	-	-	-	3	1	1	-	-	-
Shkodër	9	5	8	12	7	4	2	2	13
Tropojë	2	2	4	2	1	1	-	-	-
Has	-	-	-	1	1	1	-	-	-
Kukës	2	5	5	11	1	2	1	2	5
Fushë-Arrës	-	-	1	1	1	2	2	-	-
Pukë	4	-	1	1	1	-	-	-	-
Mirditë	2	-	7	5	1	-	2	-	2
Lezhë	4	1	7	8	1	1	2	-	9
Kurbin (Laç)	10	2	3	7	5	4	3	6	18
Kuçovë	-	1	1	1	1	2	4	-	-
Krujë	-	3	1	2	1	2	1	-	3
Fushë-Krujë	1	5	-	1	1	3	3	-	2
Tiranë	40	30	26	25	35	29	34	36	33

Të miturit në konflikt me ligjin: Analizë e faktorëve të riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve

Dibër	-	-	3	2	1	6	3	3	6
Mat	1	-	-	2	1	3	1	-	-
Bulqizë	-	-	-	-	1	4	2	1	4
Durrës	12	18	13	41	30	36	38	36	23
Kavajë	8	3	1	2	1	5	5	-	10
Rrogozhinë	2	1	-	1	1	3	1	-	-
Peqin	3	3	-	1	1	4	-	-	-
Lushnje	1	6	6	3	4	6	5	5	3
Elbasan	6	7	13	29	20	33	21	20	6
Librazhd	-	-	-	1	1	2	-	1	11
Pogradec	-	4	7	4	4	8	4	-	2
Korçë	4	6	11	10	8	9	5	2	-
Kolonjë	-	1	2	1	1	1	1	1	3
Gramsh	4	-	-	1	1	1	3	3	-
Skrapar	-	1	1	-	1	-	-	1	-
Berat	2	9	2	4	4	12	10	21	1
Vlorë	2	25	13	8	19	27	22	25	15
Fier	3	5	7	10	12	16	16	24	9
Mallakastër	-	-	2	-	-	-	2	-	20
Tepelenë	-	-	2	1	1	2	2	1	-
Gjirokastrë	-	2	6	8	6	2	3	6	1
Përmet	-	-	-	-	-	-	1	2	5
Delvinë	-	-	-	-	-	-	-	1	-
Sarandë	-	3	5	1	-	-	-	2	-

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Nëse do të krahasojmë të dhënat e vitit 2007 me të dhënat 2015, do të vëmë re një rritje të ndjeshme të numrit të të miturve të përfshirë në aktivitete kriminale. Konkretisht autorë të veprave penale kundër pasurisë dhe kundër personit për vitin 2015 janë 204 persona, nga 124 që kanë qënë në vitin 2007.

Tabela 5. Lloji i krimeve të kryera nga të miturit, 2007-2015

Lloji i veprës	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Armëmbajtje pa leje	2	5	5	17	9	16	18	18	25
Plagosje	6	3	2	14	8	6	8	20	14
Trafikim i lëndëve narkotike	5	3	10	15	21	20	17	14	15
Vjedhje	53	63	55	79	41	54	51	31	65
Vjedhje me armë	12	5	10	12	9	18	9	12	6
Vjedhje me dhunë	-	7	13	6	16	28	19	18	8
Vjedhje e mbetur në tentativë	13	8	5	4	8	6	2	-	6
Vjedhje në bashkëpunim	23	29	36	24	41	71	56	75	36
Vrasje	1	4	10	13	15	9	10	3	10
Vrasje e mbetur në tentativë	2	5	4	9	1	3	3	1	4
Dhunimi i varreve	-	-	-	-	2	-	-	-	-

Të miturit në konflikt me ligjin: Analizë e faktorëve të riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve


Marrëdhënie seksuale/ homoseksuale me minorenë	2	4	3	8	3	1	3	9	8
Pastrim i produkteve të veprës penale	-	-	-	-	2	-	1	-	-
Kanosje për moskallzim krimi	-	-	-	-	-	-	2	-	-
Vepra penale të lehta	5	12	5	9	-	-	-	-	7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Kryesisht të miturit përfshihen në akte kriminale kundër pasurisë dhe më pak kundër personit. Vihet re se vepra penale që kryejnë të miturit më së shumti është ajo e vjedhjes, sipas klasifikimeve të Kodit Penal. Po ashtu shtimi i të miturve të cilët kryejnë veprën penale të shpërndarjes apo përdorimit të lëndëve narkotike është shqetësues, sidomos gjatë viteve të fundit.


Në rastet e krimeve të kryera kundër personit në pjesën më të konsiderueshme të rasteve, viktimat janë panjohur për të miturin, ose paraqet karakteristika specifike.

Grafiku 1. Karakteristikat e viktimave të veprave penale të kryera nga të miturit.



Në vazhdim të shqyrtimit të situatës së kriminalitetit të të miturve duhet konsideruar fakti se kriminaliteti i të miturve është në rritje. Të miturit gjithnjë e më shumë po përfshihen në vepra penale të ngjashme me ato që kryejnë të rriturit. Zonat e mëdha urbane, me popullsi heterogjene janë ato ku shfaqen më shumë sjellje kriminale nga kjo grupmoshë. Në këtë kontekst duhet përmendur se strukturat për mbështetjen dhe ri-integrimin e të miturve autorë të veprave penale pas kryerjes së dënimit, janë të pakta ose mungojnë, fakt që afekton shifrat e larta të të miturve recidivistë, megjithëse se numri i tyre ka pësuar ulje vitin e fundit.

Grafik 2. Përsëritja e krimeve nga të miturit (Recidivizmi)



Për efekt të këtij studimi termi "recidivist" është përdorur për të miturit të cilët janë dënuar nga gjykata me burgim, me vendim të formës së prerë, më shumë sesa një herë për kryerjen e të njëjtës veprë (recidivist specifik) apo veprave të ndryshme penale (recidivistë të përgjithshëm).

Kreu 3

Faktorët e riskut për kriminalitetin e të miturve

3.1 Vështrim i përgjithshëm mbi faktorët e riskut

Pavarësisht se nuk ekziston ndonjë zgjidhje e mirëfilltë për parandalimin, apo korrektimin e delinkuencës së të miturve, identifikimi i faktorëve të riskut dhe të atyre mbrojtës është esencial për të zhvilluar ndërhyrjet për parandalimin e përshkallëzimit në kriminalitet të mirëfilltë.

Pjesa më e madhe e profesionistëve janë të mendimit se prezenca e një faktori të vetëm risku nuk mund të çojë në delinkuencë. Për këtë arsye është e nevojshme të operohet në disa nivele siç janë:

- Individidi;
- Familja;
- Grupi i bashkëmoshatarëve;
- Zona e banimit (lagjia);
- Shkolla.

Edhe pse disa nga faktorët e riskut janë të njëjta për një pjesë të mirë të të miturve në konflikt me ligjin, tiparet dhe kombinimi i këtyre faktorëve variojnë rast pas rasti. Pjesa më e madhe e profesionistëve janë të mendimit se ndërsa në fëmijërinë e hershme risku më i lartë vjen nga faktorët individualë, (si p.sh. komplikacione në lindje, hiperaktivitet, temperament i vështirë etj.) dhe faktorë familjarë (p.sh. sjellje prindërore antisociale apo kriminale, abuzim me substancat, neglizhencë, etj.) ndërsa fëmija rritet dhe integrohet në shoqëri fillojnë të luajnë një rol shumë të rëndësishëm, faktorët e rinj të riskut që lidhen me influencën e bashkëmoshatarëve, shkollën dhe komunitetin.

Pavarësisht rëndësisë që ka fokusimi në faktorët e riskut, analizimi i faktorëve mbrojtës që ndikojnë në reduktimin e delinkuencës është po aq i rëndësishëm për ndërtimin e strategjive efikase të ndërhyrjes. Disa faktorë mbrojtës mund të jenë:

- *Sjellja prosociale*: shfaqja e empatisë gjatë viteve të para të shkollës;
- *Gjinia*: femrat shfaqin sjellje kriminale më pak sesa meshkujt;

- *Performancë e mirë konjitive*: zhvillim i mirë gjuhësor dhe performancë e mirë akademike⁴.

3.2 Faktorët individualë të riskut

Sjellja e të miturve është rezultat i faktorëve gjenetikë, socialë dhe të mjedisit. Më poshtë janë rradhitur disa nga këta faktorë:

Sjellja antisociale

Sjellja e hershme antisociale mund të jetë parashikuesi më i saktë i shfaqjes së delinkuencës më vonë gjatë jetës. Përgjithësisht sjellja antisociale përfshin forma të ndryshme të thyerjes së rregullave dhe të agresionit, të tilla si vjedhjet, sulmet fizike dhe vandalizmi. Në fakt agresioni i hershëm duket se është një nga sjelljet sociale më doemethënëse që parashikon sjelljen delinkuente përpara moshës 13 vjeç.

Sipas një studimi të kryer në kopshte, agresioni fizik në këtë moshë, rezultoi të ishte një parashikues i mirë i përfshirjes së mëvonshme të të miturve në krimet ndaj pronës. Në të kundërt sjellja prosociale, (e tillë si dhënia e ndihmës dhe bashkëpunimi) dukej se ishte një nga faktorët mbrojtës, sidomos për fëmijët që konsideroheshin të riskuar për kryerjen e krimeve të dhunshme, apo krimeve ndaj pronës përpara moshës 13 vjeç⁵.

Mendohet se sjellja antisociale është parashikuesi më i mirë i moshës së arrestit të parë. Gjithashtu mendohet se fëmijët që janë arrestuar para moshës 13 vjeç, kanë më shumë gjasa të kthehen në recidivistë deri në moshën 18 vjeç⁶.

Të tjera studime konfirmojnë se parashikuesi më i mirë i sjelljes antisociale të mëvonshme ishte relatimi i nënave për vështirësi në lidhje me menaxhimin e

⁴ Child Delinquency, Bulletin Series, U.S Department of Justice, Office of Justice Programs, Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention, 2003.

⁵Haapasalo, J., and Trambly, R.E., "Physically aggressive boys from age 6 to 12: Family background, parenting behavior and prediction of delinquency". Journal of Consulting and Clinical Psychology, 1994.

⁶ Patterson, G.R., Crosby, L., and Vulchinich, S. "Predicting risk for early police arrest. Journal of Quantitative Criminology", 1992.

fëmijëve të tyre në moshën 3 vjeç dhe relatimi i të dy prindërve për probleme të sjelljes së fëmijëve të tyre në moshën 5 vjeç⁷.

Gjithësesi, nga studimet e kryera në këtë fushë rezulton se ndërsa pjesa më e madhe e fëmijëve që konsiderohen të vështirë për tu menaxhuar në moshën 3 vjeç nuk bëhen delinkuentë përpara moshës 13 vjeç, pjesa më e madhe e fëmijëve që bëhen të tillë përpara kësaj moshe, shfaqin probleme të sjelljes që në vitet e para të jetës. Këto studime hedhin dritë mbi rëndësinë e viteve të para të jetës, në shfaqjen e sjelljeve kriminale më vonë gjatë jetës duke vënë theksin në rëndësinë dhe ndikimin e faktorëve individualë të riskut.

Faktorët emocionalë

Studiuesit janë të mendimit se në fund të vitit të tretë të jetës, fëmijët janë në gjëndje të shprehin të gjitha llojet e emocioneve njerëzore përfshirë këtu zemërimin, krenarinë, turpin dhe fajin.

Prindërit, edukatorët, por dhe bashkëmoshatarët, influencojnë në mënyrën sesi fëmijët shprehin emocionet dhe i ndihmojnë ata të mësojnë ti menaxhojnë ato në mënyrë konstruktive. Mënyra sesi fëmijët mësojnë të shprehin emocionet që në fëmijërinë e hershme (sidomos zemërimin), mund të ndikojë në rritjen apo reduktimin e riskut të delinkuencës.

Disa studime për delinkuencën janë fokusuar në koncepte si frenimi (inhibimi) dhe aktivizimi i sjelljes. Inhibimi i sjelljes në përgjigje të stimujve të rinj, apo të ndëshkimeve, përfshin frikën, ankthin, dhe ndrojtjen. Aktivizimi i sjelljes përfshin impulsivitetin, hiperaktivitetin dhe agresivitetin. Ka të dhëna se nivele të larta të aktivizimit të sjelljes dhe nivele të ulëta të inhibimit të saj përbëjnë faktorë risku për shfaqjen e sjelljeve antisociale⁸.

Përgjithësisht studimet kanë treguar se djemtë impulsivë dhe jo ankthiozë kanë më shumë gjasa për të kryer akte delinkuente rreth moshës 12-13 vjeç. M.gj.th.

⁷ White, J.L., Moffitt, T.E., Earls, F., Robins, L., and Silva P.A., "How early can we tell? Predictors of childhood conduct disorder and delinquency. Criminology, 1990.

⁸ Farrington, D.P., "Predictors, causes and correlates of male youth violence", In youth violence, vol.24, edited by M. Tonry and M.H. Moore. Chicago I.L: University of Chicago Press, 1998.

studiuesit nuk e kanë përcaktuar nëse karakteristikat emocionale në fëmijëri përbëjnë faktorë risku, apo thjesht korrelojnë me shfaqjen e mëvonshme të sjelljes antisociale.

Tabela 6. Indikatorët e faktorëve të riskut tek të miturit⁹

Faktorët individualë të riskut

Sjellje antisociale në fëmijërinë e hershme;
Faktorë emocionalë;
Zhvillim i varfër konjitiv;
Koeфициent i ulët inteligjence;
Hiperaktivitet.

Faktorët familjarë të riskut

Lloji i prindërimit;
Keqtrajtimet;
Dhuna në familje;
Divorci i prindërve;
Psikopatologjitë e prindërve;
Sjelljet antisociale të prindërve;
Struktura e familjes;
Familjet me shumë anëtarë.

Faktorët e riskut që lidhen me grupin moshor

Shoqërimi me bashkëmoshatarë delinkuentë;
Refuzimi nga bashkëmoshatarët.

Faktorë risku që lidhen me shkollën dhe komunitetin

Dështimet në shkollë;
Performancë e ulët akademike;
Ambicje e ulët përsa i përket arritjeve akademike;
Probleme ekonomike;
Aksesi për përdorimin e armëve;
Jetesa në zona problematike përsa i përket kriminalitetit.

⁹ Loeber, R., and Farrington, D.P., "Child Delinquents: Development, Intervention and Service Needs". Thousand Oaks, CA: SAGE Publications, Inc., 2001.

Zhvillimi konjitiv

Zhvillimi i varfër konjitiv dhe problemet e sjelljes gjatë fëmijërisë së hershme mund të shpjegojnë lidhjen që ekziston mes arritjeve akademike dhe delinkuencës. Disa studime kanë treguar se inteligjenca verbale e delinkuentëve është më e ulët, sesa ajo joverbale. Delinkuentët gjithashtu kanë arritje më të ulëta akademike sesa jodelinkuentët¹⁰.

Defiçitet neuropsikologjike prezente në lindje mund të ndikojnë në shfaqjen e problemeve të sjelljes, duke qënë se ndikojnë në temperamentin e fëmijës. Këto defiçite mund të prekin kontrollin mbi të folurin, vëmendjen, agresivitetin dhe hiperaktivitetin¹¹.

Hiperaktiviteti

Studimet klinike për fëmijët hiperaktivë kanë sjellë fakte se këta fëmijë kanë risk të lartë për kryerjen e akteve delinkuente më vonë¹². Për shembull, hiperaktiviteti motor i fëmijëve të kopshteve rezultoi parashikues i mirë për sjelljet delinkuente të mëvonshme, krahasuar me mungesën e sjelljes prosociale dhe ankthit¹³.

Faktorët familjarë të riskut

Disa nga faktorët kryesorë të riskut për sjellje delinkuente të të miturve janë ato që derivojnë nga familja si p.sh., stili i prindërimit, keqtrajtimi i fëmijëve, dhuna në familje, divorci i prindërve, psikopatologjitë e prindërve, historia familjare e sjelljeve antisociale, të qenit fëmijë i prindërve adoleshentë, struktura e familjes dhe numroziteti i saj.

Stili i prindërimit

¹⁰ Fergusson, D.M., and Horwood, L.J., "Early disruptive behavior IQ, and later school achievement and delinquent behavior" *Journal of Abnormal Child Psychology*, 1995.

¹¹ Moffit, T.E., "The neuropsychology of conduct disorder" *Development and psychopathology*, 1993.

¹² Loeber, R., Green, S.M., Keenan, K., and Lahey, B.B., "Which boys still fare worse? Early predictors of the onset of conduct disorder in a six year longitudinal study" *Journal of American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 1995.

¹³ Tremblay, R.E., Pihl, R.O., Vitaro, F., and Dobkin, P.L., "Predicting early onset of male antisocial behavior from preschool behavior". *Archive of General Psychiatry*, 1994.

Praktikat e papërshtatshme të prindërimit janë ndër shkaqet dhe parashikuesit më të fuqishëm të delinkuencës¹⁴.

Krahasuar me familjet me fëmijë që nuk shfaqin probleme të sjelljes, në familjet me fëmijë që shfaqin problem të kësaj natyre, mendohet se në mënyrë të paqëllimshme përfordhet sjellja negative e fëmijëve¹⁵.

Sipas Wasserman, rezulton se tri janë praktikat e prindërimit të lidhura veçanërisht me problemet e sjelljes:

- (1) Konflikte të shpeshta mes prindërve dhe fëmijëve;
- (2) Mungesë kujdesi nga prindërit ndaj fëmijëve;
- (3) Nivel i ulët përfshirje¹⁶.

Keqtrajtimet

Keqtrajtimi, apo abuzimi me fëmijët, zakonisht bashkëshoqërohet me faktorë të tjerë familjarë risku dhe me kryerjen e akteve delinkuente në moshë të re. Duke u fokusuar sidomos në marrëdhënien midis abuzimit fizik dhe agresivitetit që shfaqin të miturit, një studim i kryer në këtë kontekst sugjeron se 20% e fëmijëve të abuzuar bëhen delinkuentë përpara moshës adulte¹⁷.

Duhet sqaruar se një pjesë e mirë e fëmijëve të abuzuar fizikisht nuk bëhen antisocialë apo të dhunshëm. Sidoqoftë një studim që krahason fëmijët pa histori abuzimi apo neglizhimi, me fëmijë të abuzuar apo të neglizhuar, zbuloi se këta të fundit kanë qënë më shumë subjekt arrestimesh deri në moshën 25 vjeç¹⁸.

Dhuna në familje

¹⁴ Hawkins, J.D., Herrenkohl, T., Farrington, D.P., Breëer, D., Catalano, R.F., and Harachi, T.W. "A review of predictors of youth violence in serious and Violent Juvenile Offenders" Risk Factors and Successful Interventions, Edited by R. Loeber and D.P Farrington. Thousand Oaks, C.A: Sage Publications, Inc., 1998.

¹⁵ Gardner, F.E.M., "Positive interaction between mothers and conduct-problem children: Is there training for harmony as well as fighting?", Journal of Abnormal Child Psychology, 1987.

¹⁶ Wasserman, G.A., Miller, L., Pinner, E., and Jaramillo, B.S., "Parenting predictors of early conduct problems in urban, high-risk boys." Journal of American Academy of Child and Adolescent Psychiatry., 1996.

¹⁷ Lewis, D.O., Mallouh, C., and Webb, J., "Child abuse, delinquency, and violent criminality". Theory and research on the Causes and Consequences of Child Abuse and Neglect, edited by D.Cicchetti and V.Carlson, New York, Cambridge University Press, 1989.

¹⁸ Widom, C.S., "The cycle of violence Science", 1989.

Të qënit dëshmitarë të dhunës në familje ndikon në rritjen e problemeve të sjelljes sidomos te fëmijët meshkuj¹⁹. Po ashtu sipas studimeve të kryera në këtë fushë rezultojnë se në shumë familje ku ushtrohet dhunë ndaj nënave, ushtrohet dhunë njëkohësisht dhe ndaj fëmijëve²⁰.

Të qënit i abuzuar, apo dëshmitar i dhunës në familje mendohet se prek sjelljen e të miturve dy herë më shumë sesa të qënit vetëm dëshmitar i dhunës²¹.

Një tjetër faktor që e rrit riskun në familjet e dhunshme, përfshin incidencën e lartë të problemeve të tjera të sjelljes, si abuzimi me alkoolin dhe burgimi. Distresi psikologjik i nënave në mënyrë indirekte është gjithashtu një faktor që ekspozon fëmijën ndaj një risku më të lartë, duke qënë se këto nëna janë të padisponueshme emocionalisht për tu kujdesur për ta²².

Divorci i prindërve

Krahasuar me djemtë prindërit e të cilëve kanë qëndruar të martuar, djemtë me prindër të divorcuar mendohet se shfaqin më shumë probleme të sjelljes antisociale dhe jokompliante rreth moshës 10 vjeç²³. Sidoqoftë, duke marrë parasysh faktorët e shumtë që lidhen me funksionimin apo mosfunksionimin e familjes, është e vështirë të nxirren konkluzione të sakta mbi efektin real që ka divorci i prindërve në sjelljen e mëvonshme të fëmijëve.

Psikopatologjitë e prindërve

Sipas rezultateve të një studimi të kryer, rreth 45% e prindërve të djemve të mitur me probleme të sjelljes, vuajnë nga çrregullimi antisocial i personalitetit²⁴.

Nivele të njëjta janë raportuar për abuzimin me substanca dhe depresionin²⁵.

¹⁹ Reid, W.J., and Crisafulli, A., "Marital discord and child behavior problems: A meta analysis", Journal of Abnormal Child Psychology, 1990.

²⁰ McKibben, L., De Vos, E., and New Berger, E., "Victimization of mothers of abused children: A controlled study", 1989.

²¹ Hughes H.M., Parkinson, D., and Vargo, M., "Witnessing spouse abuse and experiencing physical abuse", Journal of Family Violence, 1989.

²² Zuckerman, B., Augustyn, M., Groves, B.M., and Parker, S., "Silent victim revisited: the special case of domestic violence", 1995.

²³ Hetherington, E.M., "Coping with family transitions: Winners, losers and survivors. Child Development", 1989.

²⁴ Lahey, B.B., Piacentini, J.C., Mc Burnett, K., Stone, P., Hartdagen, S., and Hynd, G., "Psychopathology in the parents of children with conduct disorder and hyperactivity", Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry, 1988.

Prindërit depresivë shfaqin shumë deficienca përsa i përket rolit që u duhet të luajnë në jetën e fëmijës, gjë që shoqërohet me nivele të larta të shfaqjes së sjelljeve antisociale te fëmijët.

Po ashtu psikopatologjitë nga të cilat mund të jenë të prekur prindërit lidhen me nivele të larta të shfaqjes së çrregullimeve psikiatrike te fëmijët²⁶.

Sjelljet antisociale brenda familjes

Një histori e gjatë kërkimesh tregon se sjellja agresive dhe kriminaliteti kanë prevalencë më të lartë në disa familje sesa në disa të tjera. Adultët antisociale preferojnë të zgjedhin partnerë po antisociale²⁷. Po ashtu, rezulton se prindërit antisociale krijojnë më shumë konflikte brenda familjes, tentojnë ti mbikqyrin më pak fëmijët dhe sillen më ashpër me ta.

Për më tepër të pasurit e një vëllai me personalitet antisocial mendohet se rrit gjasat për shfaqjen e sjelljeve antisociale. Mendohet se influenca e vëllezërve në këtë aspekt është më e madhe kur fëmijët kanë pak diferencë moshe midis tyre²⁸.

Të qënurit fëmijë i prindërve adoleshentë

Fëmijët e nënave adoleshente kanë më shumë gjasa për të kryer akte kriminale në adoleshencë²⁹.

Sa më sipër mund të ketë lidhje me personalitetin antisocial të nënës, apo dhe me lidhjet e saj me partnerë antisociale³⁰.

Struktura e familjes

²⁵ Robins, L.N., "Deviant Children Grown Up", Baltimore, MD. Williams and Wilkins, 1966.

²⁶ Costello, E.J., Farmer, E.M., Angold, A. Burns, B., and Erkanli, A., "Psychiatric disorders among American Indian and White youth in Appalachia: The great Smoky Mountains Study". American Journal of Public Health, 1997.

²⁷ Farrington, D.P., Barnes, G.C., and Lambert, S., "The concentration of offending in families". Legal and Criminological Psychology, 1996.

²⁸ Farrington, D.P., "The development of offending and antisocial behavior from childhood: Key findings from the Cambridge Study in Delinquent Development." Journal of Child Psychology and Psychiatry, 1995

²⁹ Conser, A., Rivara, F.O., Barnowsky, R., and Emmanuel, I., "Maternal and perinatal risk factors for later delinquency", 1997.

³⁰ Rutter, M., Giller, H., and Hagell, A., "Antisocial Behavior by Young People", New York, Cambridge University Press, 1998.

Shumë nëna të vetme (në mungesë të një partneri), janë të afta t'i rrisin fëmijët në mënyrë të përshtatshme. Sidoqoftë, studimet tregojnë se fëmijët e rritur nga nëna të vetme shtëpiake janë më të rrezikuar për të shfaqur probleme të sjelljes³¹.

Kjo gjë është e lidhur dhe me faktin që këto nëna zakonisht kanë më pak burime për të siguruar të ardhurat e familjes. Të tjerë faktorë po ashtu mund të shpjegojnë këtë korrelacion. Krahasuar me nënat që kanë një partner, nënat e vetme raportojnë më shumë probleme të shëndetit mendor. Këto probleme ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën sesi ato kudesen për fëmijët e tyre³².

Po ashtu, këto nëna mund të ndryshojnë shpesh vendbanim dhe kanë më pak mundësi për të monitoruar aktivitetet në të cilat përfshihen fëmijët e tyre³³. Si përfundim, mund të dalim në një konkluzion të përgjithshëm se secili nga faktorët e lartpërmendur mund të kontribuojnë në rritjen e gjasave për sjelljen problematike të fëmijëve. Zakonisht këta faktorë gjenden të kombinuar me njëri-tjetrin, kështu që është e vështirë të përcaktohet masa e ndikimit të secilit prej tyre në përfshirjen e të miturve në aktivitete të jashtëligjshme.

Familjet e mëdha

Sa më shumë fëmijë të jenë në familje, aq më i lartë është rreziku për delinkuencë. Nga një studim i Cambridge rezultoi se krahasuar me djemtë që kishin më pak motra e vëllezër, djemtë të cilët kishin katër apo më shumë të tillë rreth moshës 10 vjeçare ishin dy herë më të rrezikuar për të shfaqur sjellje antisociale pavarësisht nga statusi socio-ekonomik i familjes³⁴. Këto rezultate mund të lidhen me mundësitë më të pakta të prindërve me shumë fëmijë për ti monitoruar ata, apo dhe me mundësitë më të pakta ekonomike për t'u ofruar fëmijëve supervision të përshtatshëm dhe mbështetje ekonomike.

³¹ Pearson, J.L., Ialongo, H.S., Hunter, A.G., and Kellum, S.G., "Family Structure and Aggressive behavior in a population of urban elementary school children", *Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 1994.

³² Guttentag, M., Salasin, S., and Belle, D., "The mental Health of Women", New York, Academic Press, 1980.


³³ McLanahan, S., and Booth, K., "Mother-only families: Problems, prospects and politics", *Journal of Marriage and Family*, 1989.

³⁴ West, D.J., and Farrington, D.P., "Who became delinquent?", London, England, 1973.

Tabela 7. Tregues rreth ambientit familjar që i përkasin të miturve në IEVP

Treguesit	Po	Disi	Jo	Nuk e di
Anëtarë të familjes të përfshirë në aktivitet kriminal	10	3	59	-
Anëtarë të familjes të dënuar	21	3	48	-
Anëtarë të familjes që abuzojnë me alkoolin	7	4	48	-
Anëtarë të familjes që nuk kanë treguar interes/përkujdesje	9	7	50	4
Mbikqyrje e parregullt dhe stil prindërimi pa kufij	5	7	53	3
Eksperiencia abuzimi (fizik, sex., emocional)	3	4	51	3
Dëshmitar i përdorimit të dhunës në familje	4	8	57	1
Ka përjetuar humbje/ vdekje të anëtarëve të familjes	17	3	49	2
I është dashur të kujdeset për anëtarët e tjerë të familjes	24	7	38	4
Probleme të tjera (probleme fizike, mendore, braktisje nga njëri/të dy prindërit, divorc, faktorë të tjerë stresi).	8	5	52	6

Grafik 3. Tregues të ambientit familjar të të miturve



Faktorët e riskut që lidhen me bashkëmoshatarët

Krahasuar me influencën e faktorëve individualë dhe familjarë, influenca e bashkëmoshatarëve në kryerjen e akteve kriminale nga të miturit zakonisht është më e fortë në një periudhë më të vonë. Dy mekanizmat kryesorë që lidhen me influencën e bashkëmoshatarëve janë *shoqërimi me bashkëmoshatarë me sjellje devijante* dhe *refuzimi nga bashkëmoshatarët*.

Shoqërimi me bashkëmoshatarë me sjellje devijante

Që nga një raport i vitit 1931, i cili tregoi se 80% e të miturve të arrestuar për kryerjen e akteve kriminale në qytetin e Çikagos, i kryenin këto akte në bashkëpunim me të mitur të tjerë, të dhënat empirike kanë mbështetur teorinë në

fjalë që ka të bëjë me influencën e bashkëmoshatarëve në kryerjen e akteve kriminale³⁵.

Ende është e paqartë nëse janë bashkëmoshatarët me sjellje devijante që modelojnë dhe përforcojnë sjelljen antisociale, apo nëse shoqërimi me bashkëmoshatarë me sjellje devijante është një tjetër manifestim i predispozitës që kanë disa të mitur për të kryer akte kriminale.

Në këtë kontekst mendohet se bashkëmoshatarët me sjellje devijante kanë më shumë influencë te të miturit me një histori kriminale, përse i përket rritjes së numrit dhe ashpërsisë së akteve kriminale. Kërkime në këtë fushë kanë sjellë të dhëna që tregojnë se grupet kriminale ushtrojnë një ndikim të konsiderueshëm në sjelljen delinkuente të anëtarëve të tyre duke imponuar konformimin e anëtarëve me normat e grupit³⁶.

Refuzimi nga bashkëmoshatarët

Të dhënat që tregojnë se refuzimi nga bashkëmoshatarët është një faktor risku për sjelljet antisociale, janë relativisht të reja krahasuar me të dhënat për influencën që kanë bashkëmoshatarët në këtë kontekst. Kërkimet e fundit kanë treguar se të miturit e refuzuar nga bashkëmoshatarët janë shumë herë më të rrezikuar për të shfaqur sjellje antisociale në mënyrë të përsëritur në të ardhmen, krahasuar me fëmijët që nuk kanë qënë të refuzuar³⁷.

Tabela 8. Faktorë të riskut që lidhen me bashkëmoshatarët dhe stilin e jetesës

Faktorë risku	Po	Jo	Nuk e di
Mungojnë shokët e moshës së tij	17	55	0
Shoqërohet me bashkëmoshatarë të përfshirë në sjellje antisociale	34	52	1
Mungojnë shokët/bashkëmoshatarët jo të lidhur me sjelljet kriminale	21	49	3
I mituri ka kryer veprën/at penale në grup me bashkëmoshatarët	27	46	1

³⁵ Shaw, C.T., and McKay, H.D., Report and Causes of Crime, vol.2, Washington, DC: U.S Government Printing Office, 1931.

³⁶ Howell, J.C., Youth Gangs: An Overview Bulletin, Washington D.C., U.S., Department of Justice, Office of Justice Programs, Office of Juvenal Justice and Delinquency Prevention, 1998.

³⁷ Child Delinquency, Bulletin Series, U.S Department of Justice, Office of Justice Programs, Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention, 2003.


Nuk kishte me se të kalonte kohën e lirë/aktivitete sociale	34	37	3
Kohën e lirë e kalonte në rrugë ose ambiente kryesisht për të rritur	41	35	0
Pjesëmarrje në aktivitete të rrezikshme	19	42	0
I mituri nuk kishte akses në të holla (burimi: familja puna)	33	41	0

Faktorët e riskut që lidhen me shkollën

Studime të ndryshme sugjerojnë se dështimi në shkollë gjatë fëmijërisë mund të ndikojë në përfshirjen e të miturve në akte kriminale. Për më tepër, defiçencat e hershme neurologjike, kombinuar me dështimin e familjes, shkollës dhe komunitetit për të siguruar një proces të përshtatshëm socializues çojnë po ashtu në delinkuencë. Një nga faktorët e riskut të lidhura me shkollën është performanca e ulët akademike³⁸.

Në studimet e kryera me fëmijët e moshave 8-11 vjeç janë gjetur të dhëna që tregojnë se performanca akademike lidhet drejtpërdrejt me kriminalitetin e mëvonshëm³⁹. Fëmijët që nuk janë të prokupuar përse i përket shkollës, (pra që kanë aspirata dhe motivim të ulët përse i përket arsimimit), janë po ashtu të rrezikuar për kryerjen e akteve delinkuente.

Grafiku 4. Niveli arsimor i përfunduar nga të miturit në IEVP



³⁸ Maguin, E., and Loeber, R., "Academic performance and delinquency", In Crime and Justice: A Review of Research, vol. 20, edited by M. Tonry. Chicago I.L: University of Chicago Press, 1996.

³⁹ Hawkins, J.D., Herrenkohl, T., Farrington, D.P., Breëer, D., Catalano, R.F., and Harachi, T.W. "A review of predictors of youth violence in serious and Violent Juvenile Offenders" Risk Factors and Successful Interventions, Edited by R. Loeber and D.P Farrington. Thousand Oaks, C.A: Sage Publications, Inc., 1998.

Të miturit në konflikt me ligjin: Analizë e faktorëve të riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve

Shënim: Të dhënat mbi arsimin e përfunduar janë marrë nga intervistimi i 78 të miturve të akomoduar në IEVP-të, pra bazuar në vetëdeklarimet e tyre. Nuk ka garanci për saktësinë e këtyre të dhënave.

Grafiku 5. Arsyet e evidentuara nga të miturit për ndërprerjen e shkollimit.




Tabela 9. Faktorë të tjerë risku që lidhen me shkollimin/punësimin e të miturve

Faktorë risku	Po	Disi	Jo	Nuk e di
Qëndrim negative ndaj shkollës/punës	13	9	47	-
Lidhje e dobët me shkollën	20	11	38	-
Largime të shpeshta nga shkolla	28	8	34	-
Ngacmime në shkollë	7	2	63	1
Marrëdhënie jo të mira me shumicën e mësuesve	15	9	40	-
Dëmtim të ambienteve të shkollës	10	5	55	-
Qëndrime negative mospërfillëse të prindërve/kujdestarëve ndaj shkollimit/punësimit	6	2	60	1

Faktorët e riskut që lidhen me komunitetin

Shumë faktorë risku për delinkuencën e të miturve, janë të lidhur me komunitetin. Nga kërkimet e bëra rezulton se fëmijët e rritur në familje të varfra janë më të rrezikuar sesa ata të rritur në familje me kushte të mira ekonomike. Po ashtu, rezulton se fëmijët e rritur në lagje të varfëra, janë më të rrezikuar për zhvillimin e sjelljeve antisociale, sesa ata të rritur në lagje të pasura⁴⁰.

⁴⁰ Catalano R.F., and Hawkins, J.D., The social development model: A theory of antisocial behavior. In delinquency and crime: Current Theories, edited by J.D.Hawkins, New York, Cambridge University Press, 1996.

Të miturit që jetojnë në lagje apo zona me nivele të larta kriminaliteti janë shpesh të ekspozuar ndaj normave që favorizojnë krimin dhe për pasojë janë në rrezik për të kryer akte kriminale⁴¹.

Për më tepër, të pasurit akses ndaj armëve përgjithësisht rrit rrezikun për dhunë⁴². Shoqëria shqiptare është dëshmitare e korrelacionit të aksesit ndaj armëve dhe rritjes së akteve kriminale duke i'u referuar ngjarjeve tragjike të vitit 1997.

Grafiku 6. Vendbanimi i të miturve që ndodhen në IEVP




Tabela 10. Faktorët e riskut në komunitet

Faktorë risku në komunitet	Po	Jo	Nuk e di
Përdorim/ tregtim i drogave	20	48	3
Izolimi (Janë të pakta mjetet e transportit)	20	48	1
Mungojnë ambiente/aktivitete të moshës	33	28	2
Dallohet për tension racial, fetar apo etnik	9	53	3
Dallohet për nivel të lartë varfërie apo papunësie	31	35	2
Dallohet për nivel të lartë kriminaliteti	13	50	4
Probleme të tjera (mungojnë shërbime publike)	26	39	2
Tensione mes policisë, pushtetit lokal	6	55	8
I mituri ka kryer veprën penale në komunitetin ku jeton	40	28	-

⁴¹ Developmental Research and Programs; Promising Approaches to Prevent Adolscnt Problem Bahaviors. Seattle WA: Developmental Research and Programs, 1996.

⁴² Brewer, D.D., Hawkins, J.D., Catalano R.F., and Neckerman , H.J., Preventing serious, violent and chronic juvenile offending: A revieë of evaluations of select strategies in childhood, adolescence and the community, 1995.

Kreu 4

Profili i të miturve në konflikt me ligjin

4.1 Vështrim i përgjithshëm i profilit të të miturve në konflikt me ligjin

Nuk ekziston një përshkrim unik i profilit të të miturve në konflikt me ligjin, pasi një sjellje antisociale shfaqet si pasojë e ndërthurjes së faktorëve psikologjikë, familjarë dhe socialë shumë të ndryshëm rast pas rasti.

Në rastin e çrregullimeve psikike të dyshuara si favorizuese sjelljesh antisociale, vetëm në një numër të kufizuar të rasteve, sjellja delinkuente shfaqet e lidhur me çrregullimet psikotike që shquhen nga një alternim i ashpër i kuptimit të realitetit. Çrregullimet e përshkruara nën termin e psikopatisë janë vënë re tek rreth 15%-20% e delinkuentëve. Ndonjëherë personaliteti i delinkuentit mund të duket si normal, apo i pacënuar. Kalimi në aktin kriminal të adoleshentit nuk është veçse një episod rinor reaksioni që do të kalojë në maturim. Problemi qëndron tek ndihma që i duhet dhënë subjekteve të tilla të dalin nga kjo gjëndje⁴³.

Sipas D.W. Winnicott⁴⁴, në rrënjën e tendencës antisociale, ka gjithmonë një mungesë, qoftë thjeshtë nga një impuls i dhënë nga nëna ku ajo ka qënë e mbyllur në vetëvete, e ligështuar, qoftë kur familja ka qënë jokompakte apo ka tendenca antisociale. Ka gjithmonë një bërthamë të shëndoshë e menjëherë një ndërprerje, pas së cilës gjërat nuk kanë qënë më si më parë. Duket sikur fëmija antisocial kërkon në një mënyrë, apo në një tjetër të bëjë të njohur borxhin që bota ka ndaj tij, apo duke u përpjekur që bota të riparojë atë që ka shkatërruar.

Nga një këndvështrim delinkuencën mund ta konsiderojmë si shenjë të falimentimit të një procesi psikik normal të socializimit. Shkurt, gjithcka që do të vërë në punë mekanizmin e të mësuarit të tolerancës së frustracionit dhe identifikimit rrezikon të jetë në origjinë të sjelljeve antisociale.

⁴³ Shëndeti Mendor dhe të Drejtat e Njeriut, Botim i Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës, Vol.3, 2004.

⁴⁴ Winnicot. D.W, Deprivation and delinquency, 1984, www.routledge.com.

Duke hedhur vështrimin mbi realitetin në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale rezulton se nga 78 të mitur që ndodheshin në këto institucione në momentin e intervistimit, rreth 10% e tyre janë diagnostikuar me probleme të shëndetit mendor.

4.2 Profili i të miturve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP).

Për shumë të mitur në institucionet penitenciare sjelljet delinkuente janë sjellje të mësuara në ato vite të cilat janë më të rëndësishme për formimin e individit. Këto sjellje shpesh janë pasojë e ndikimit të faktorëve të jashtëm (familja, bashkëmoshatarët, media) dhe faktorëve të brendshëm siç janë mungesa e aftësive konjitive dhe sociale për të zhvilluar sjellje prosociale, të prirur nga e mira e përbashkët.

Të miturit në konflikt me ligjin zakonisht janë mjaft impulsivë, kanë vështirësi për të kontrolluar zemërimin e tyre si dhe frustrohen lehtë. Në përgjithësi ata kanë tendencën të gjykojnë në mënyrë egocentrike si dhe priren nga plotësimi i nevojave vetjake pa marrë parasysh pasojat e sjelljeve të tyre.

Një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikon në kriminalitetin e të miturve në Shqipëri është mjedisi familjar. Në evidencat që disponohen mbi gjendjen familjare të të miturve në institucionet penitenciare në Shqipëri vihet theksi mbi divorcet e prindërve, apo në konfliktet brenda familjes.

Tabela 11. Kontaktet e të miturve në IEVP me prindërit dhe anëtarë të familjes

Treguesit	2007		2008		2009		2010		2011		2012		2013		2014		2015	
	D	P/b	D	P/b	D	P/b	D	P/b	D	P/b	D	P/b	D	P/b	D	P/b	D	P/b
Numri i të miturve që kanë patur kontakte	23	89	25	65	22	103	10	143	11	79	56	97	43	91	28	86	13	123
Numri i të miturve që kanë patur kontakte të kontaktuar.	6	5	6	12	10	14	5	36	6	36	35	53	22	54	24	79	20	75
Numri i të miturve që nuk kanë kontaktuar.	1	2	-	3	3	4	2	4	1	6	6	5	8	9	8	13	3	9

Sqarim: D- I dënuar P/b- I paraburgosur

Shpesh haset një mungesë edukimi, në formën e një neglizhimi të thellë të prindërve ndaj fëmijëve, të një mungese autoriteti kryesisht atëror, një edukim i papërshtatshëm, në disa raste strikt, apo një qëndrim i butë, apo dhe inkohorent që dallohet nga oshilacione brutale.

Po ashtu faktorët socialë janë të rëndësishëm në sjelljet delinkuente të shfaqura. Ndryshimet radikale të kushteve të jetesës, të vlerave sociale, periudhat e trazuar socio-politike janë gjeneratorë të antisocialitetit.

Nga intervistat me të burgosurit e mitur rezulton se disa nga karakteristikat kryesore të evidentuara në një pjesë të konsiderueshme të tyre gjenerohen nga faktorë individualë të riskut dhe faktorë të riskut që lidhen me ambientin social. Përsa i përket karakteristikave individuale të të miturve në konflikt me ligjin mund të përmendim:

a) Kualifikim profesional i pakët ose mungesë kualifikimi.

Nga intervistat me të miturit në institucionet penitenciare në vend, rezulton se një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk kanë kualifikim profesional. E kombinuar kjo dhe me mungesën e arsimimit është një faktor shqetësues në organizimin e kohës së të miturve dhe shoqërizimit të tyre me bashkëmoshatarë problematikë.

b) Nivel arsimor i ulët

Një pjesë e konsiderueshme e të miturve në I.E.V.Penale rezulton të mos ketë përfunduar arsimin e detyruar, kryesisht për arsye ekonomike por dhe për arsye të tjera të karakterit social.

c) Toksikomania

Rezulton se është rritur numri i të miturve që përfshihen në vepra penale që kanë të bëjnë me përdorimin dhe shfrytëzimin e lëndëve narkotike. Aktualisht autoritetet e këtyre institucioneve pohojnë se është rritur numri i të miturve përdorues të drogave.

Tabela 12. Faktorë risku që lidhen me përdorimin e drogave

Faktorë risku që lidhen me përdorimin e drogave	Po	Jo	Nuk e di
Sjellje që vënë të miturin në rrezik real (injektim/përdorim drogash)	9	60	0
E konsideron përdorimin e substancave të domosdoshëm	5	65	1
Efekte dëmtuese në arsimim /marrëdhënie/ jetën e përditshme	14	56	2
Ka kryer vepra penale për të siguruar/blerë drogë	5	67	0
Ka tregtuar/shkëmbyer drogë	10	61	0
Sjellje të tjera lidhur me drogën (sjellje kriminale, mashtrim).	7	64	0

d) Mohim apo mosbesim ndaj autoriteteve

Nga intervistat me specialistë që punojnë drejtpërdrejtë me këtë kategori në institucionet penitenciare rezulton se pjesa më e madhe e tyre kanë një sjellje më sfiduese ndaj figurave autoritare, krahasuar me të rriturit e burgosur.

e) Egocentrizëm dhe mungesë empatie

Të miturit në konflikt me ligjin zakonisht janë mjaft impulsivë, kanë vështirësi për të kontrolluar zemërimin e tyre si dhe frustrohen lehtë. Në përgjithësi ata kanë tendencën të gjykojnë në mënyrë egocentrike si dhe priren nga plotësimi i nevojave vetjake pa marrë parasysh pasojat e sjelljeve të tyre.

f) Vetëkontroll i pakët

Një pjesë e konsiderueshme e të miturve në institucionet penitenciare rezulton se kanë pak vetëkontroll, si dhe probleme në aspektin e socializimit.

Tabela 13. Perceptimi i vetes dhe të tjerëve nga të miturit

Faktorë risku që lidhen me perceptimin e vetes dhe të tjerëve	Po	Jo	Nuk e di
Ka nivel të papërshtatshëm vetëvlerësimi (shumë të ulët/shumë të lartë)	20	46	3
Nuk beson te të tjerët	25	41	6
Shikon veten si viktimë të diskriminimit apo trajtimit të padrejtë në institucion, familje, shkollë, komunitet	2	69	2
Ka qëndrime diskriminuese ndaj të tjerëve (racë, etni, klasë sociale, mosha)	4	65	0
E perception veten si kriminel	3	69	0

Tabela 14. Mënyra e të menduarit dhe sjelljet e të miturve

Faktorë risku që lidhen me mënyrën e të menduarit dhe sjelljen	Po	Jo	Nuk e di
Nuk kupton pasojat e veprimeve të veta (afatgjata, të menjëhershme, direkte, indirekte)	25	48	0
Është impulsive (vepron pa menduar dhe më vonë pendohet)	26	49	0
Dorëzohet lehtë para presionit të të tjerëve	8	65	0
Temperament agresiv dhe mungesë vetëkontrolli	18	52	0
Aftësi të varfra sociale/të komunikimit	18	55	1

g) Stil konjitiv impulsiv dhe i ngurtë

Të miturit në konflikt me ligjin prirën të gjykojnë të tjerët në mënyrë impulsive, pa krijuar një kuadër të plotë për personat me të cilët ndërveprojnë, apo për situatat në të cilat ndodhen.

h) Mungesë aftësie për menaxhimin e konflikteve

Një pjesë e mirë e të miturve nuk arrijnë të frenojnë impulset agresive dhe si pasojë kanë probleme në menaxhimin apo shmangien e konflikteve.

Përsa i përket mjedisit social në të cilin janë rritur të miturit në konflikt me ligjin mund të përmendim disa karakteristika, si:

a. Familje të mëdha, të pastrukturuara dhe problematike

Një pjesë e mirë e të miturve në institucionet penitenciare vijnë nga familje të mëdha, me shumë fëmijë, ose nga familje me problematika të ndryshme si divorci i prindërve, emigrimi apo vdekja e njërit prind.

b. Shoqëria me grupe të marxhinalizuara.

Një pjesë e të miturve në konflikt me ligjin pohojnë se shoqërohen me të mitur të tjerë, ose me të rritur të cilët kanë kryer vepra penale. Duke qënë se vjedhja në bashkëpunim është një ndër veprat penale me incidencë më të lartë, në pjesën më të madhe të rasteve disa të mitur ndodhen në paraburgime dhe burgje bashkë me të mitur të tjerë të akuzuar apo dënuar për kryerjen e të njëjtës vepër penale.

c. Problemet ekonomike

Në përgjithësi, të miturit në institucione penitenciare vijnë nga familje me burime të pakta financiare. Në pjesën më të madhe të rasteve këto familje janë zhvendosur nga zonat rurale në ato urbane dhe kanë hasur në vështirësi të mëdha ekonomike, por dhe në vështirësi për tu integruar kulturalisht.

d. Mosfunksionim i mekanizmave të kontrollit familjar, shkollor dhe institucional.

Edhe në këtë drejtim vihet re se një pjesë e të miturve të përfshirë në akte kriminale, siç dhe është përmendur më lart, vijnë nga familje të cilat për arsye të ndryshme nuk kanë shumë supervizion apo kontroll ndaj fëmijëve. Po ashtu sistemi arsimor nuk ofron zgjidhje të përshtatshme për përfshirjen e të miturve “problematikë” në procesin arsimor.

Si konkluzion i të dhënave të prezantuara përse i përket të miturve në konflikt me ligjin mund të thuhet në mënyrë të përmblodhur se:

- Në përgjithësi të miturit në konflikt me ligjin janë meshkuj. Vetëm në raste shumë të rralla mund të takohen vajza të mitura të akuzuara për vepra të ndryshme penale.
- Të miturit në konflikt me ligjin përgjithësisht kanë nivel të ulët arsimor.
- Në shumicën e rasteve të miturit vijnë nga familje me probleme të mprehta sociale dhe ekonomike.
- Një pjesë e të miturve në konflikt me ligjin në përgjithësi vijnë nga zona rurale të cilat nuk ofrojnë shumë mundësi mbijetese dhe jetojnë në zona urbane.
- Një pjesë e të miturve në konflikt me ligjin vijnë nga familje me problematika të ndryshme, si divorci, dhuna, vdekja e njërit prind, etj.
- Të miturit në konflikt me ligjin karakterizohen nga modelimi i sjelljeve problematike që në moshë të vogël.

Kreu 5

Parandalimi dhe ndërhyrja

Parandalimi dhe ndërhyrja janë dy koncepte të ndryshme. Parandalimi nënkupton marrjen e masave për të mos lejuar shfaqjen e problemit dhe drejtohet ndaj të gjithë popullatës. Ndërhyrja realizohet me individët më të rrezikuar, apo të përfshirë në sjellje kriminale dhe synon reduktimin apo eliminimin e sjelljeve problematike.

5.1 Modelet e suksesshme të parandalimit të kriminalitetit të të miturve

Ekzistojnë programe të ndryshme, të cilat kanë rezultuar të suksesshme për parandalimin dhe trajtimin e sjelljeve delinkuente. Në përgjithësi programe efikase konsiderohen ato që:

- Identifikojnë faktorët e riskut dhe ata mbrojtës, ndaj të cilëve janë të ekspozuar të miturit.
- Fokusohen më shumë tek të miturit e ekspozuar ndaj faktorëve të riskut.
- Ofrojnë ndërhyrje në plane/drejtime të ndryshme.
- Janë intesive dhe të vazhdueshme.
- Marrin në konsideratë pikat e forta dhe të dobëta të të miturve.
- Merren jo vetëm me individin, por dhe me ambientin social që e rrethon⁴⁵. Parandalimi i hershëm redukton gjasat që të miturit të përfshihen në sjellje problematike. Programet primare parandaluese përfshijnë të gjithë të miturit dhe jo vetëm ata që shfaqin sjellje kriminale. Përveç këtyre programeve ekzistojnë dhe programe parandaluese dytësore të cilat përfshijnë të miturit që kanë shfaqur tendenca për tu përfshirë në sjellje kriminale. Për të miturit të cilët janë përfshirë në sjellje kriminale ndërtohen programe specifike trajtimi.

Qëllimi i trajtimit nëpërmjet këtyre programeve është të mësuarit e strategjive për të rritur nivelin e ndërgjegjësjësimit dhe të autokontrollit në përballje me situata problematike. Në aplikimin e programeve është e rëndësishme të punuarit në ekipe

⁴⁵ Child Delinquency, Bulletin Series, U.S Department of Justice, Office of Justice Programs, Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention, 2003.

multi-disiplinare, për trajtimin në aspekte të ndryshme (psiko-sociale, edukative, arsimore).

Menaxhimi i të miturve me tendenca për tu përfshirë në sjellje delinkuente është një sfidë e vazhdueshme. Sipas literaturës, nëse këto tendenca identifikohen në fëmijëri ose adoleshencë, trajtimi është më efektiv sesa në rastin kur identifikohen tek adultët. Zhvillimi i marrëdhënieve ndërpersonale mund të jetë një nga qëllimet e trajtimit. Vendosija e një marrëdhënieje besimi me individin do të jetë më produktive sesa konfrontimi me zemërim, ndëshkimet dhe disiplina e rreptë. Vendosija e kufijve dhe e pritshmërive të qëndrueshme dhe me sens logjik është me rëndësi në mënyrë që të kultivohet përgjegjshmëria individuale për veprimet e kryera. Për një trajtim sa më efektiv rekomandohet bashkëpunimi me familjen, përfshirja në programe arsimimi si dhe caktimi i detyrave specifike të cilat kanë një qëllim të caktuar.

Disa nga strategjitë kryesore të parandalimit janë trajnimi i të miturve, forcimi i marrëdhënieve familjare, përfshirja e të miturve në procesin arsimor, në aktivitete edukative, apo sportive si dhe bashkëpunimi me komunitetin.

a) *Trajnimi i të miturve*

Trajnimi i të miturve përfshin të mësuarin e aftësive të reja të cilat do të lehtësojnë procesin e rritjes, zhvillimin dhe funksionimin e përshtatshëm. Kërkimet e kryera në këtë fushë sugjerojnë se për parandalimin e çrregullimit të sjelljes është e nevojshme të zhvillohen aftësitë e të miturve. Këtu përfshihen aftësitë për të ndërvepruar në mënyrë efektive me të tjerët, kryerjen me sukses të detyrave të caktuara, dhe përdorimin e aftësive për një funksionim sa më të përshtatshëm. Kjo nënkupton të mësuarit e aftësive për zgjidhjen e problemeve, qëndrueshmërisë dhe vetë-kontrollit, dhe zhvillimin e sjelljeve prosociale në vend të atyre antisociale. Aftësitë prosociale zhvillohen nëpërmjet të mësuarit të sjelljeve të përshtatshme zhvillimin e shoqërizimit dhe komunikimit. Zhvillimi social i të miturve i pajis ata me aftësitë e nevojshme për të ndërvepruar pozitivisht me mjedisin.

b) *Forcimi i marrëdhënieve familjare*

Marrëdhëniet solide me familjen luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe trajtimin e sjelljeve delinkuente. Çdo i mitur ka nevojë të konsiderohet si pjesë e një

sistemi më tepër sesa si një entitet i veçantë. Kërkimet e bëra kanë treguar se prindërit e të miturve më çrregullime të sjelljes kanë pasur një stil prindërimi defiqitar.

Forcimi i marrëdhënieve mes të miturve dhe familjarëve përmes lehtësimit të vizitave, referimit të shqetësimeve të fëmijës, mbajtjen e kontakteve me prindërit dhe organizimin periodikisht të aktiviteteve me praninë e prindërve të të miturve do të shërbenin për krijimin e një klime gjithnjë e më të sigurtë për të miturit.

c) *Arsimimi, programet edukative dhe aktivitetet sportive*

Përfshirja e të miturve në programe arsimore formale dhe joformale luan një rol të rëndësishëm në trajtimin e çrregullimeve të sjelljes. Aktivitetet me karakter edukues duhet të kenë në fokus menaxhimin e zemërimit, zhvillimin e aftësive sociale dhe komunikimit, shpërblimin e sjelljeve të përshtatshme, si dhe inkurajimin e të miturve për të kuptuar ndjenjat e tyre, për të qënë miqësorë, për të komunikuar normalisht.,etj. Në këtë kontekst sugjerohet që për këtë kategori të reduktohen sa më shumë të jetë e mundur sjelljet ndëshkuese, dhe në vend të tyre të përdoret përforcimi dhe shpërblimet në mënyrë që të miturit ta ndjejnë veten të vlerësuar për pjesëmarrjen në këto lloj aktiviteteve.

Aktivitetet sportive janë të rëndësishme dhe të dobishme jo vetëm fizikisht, por dhe psikologjikisht, pasi ulin nivelin e stresit dhe rrisin vetëvlerësimin. Këto aktivitete duhet të alternohen, (pra të jenë të llojeve të ndryshme) në mënyrë që të mos bëhen rutinë, si dhe të jenë të organizuara në mënyrë që të miturit të stimulohen dhe ta ndjejnë veten të vlerësuar për pjesëmarrjen.

d) *Bashkëpunimi me komunitetin*

Në trajtimin e të miturve me rëndësi do të ishte sigurimi i mbështetjes dhe bashkërendimi i punës me organizma shtetërorë ose privatë që operojnë në fushën e trajtimit të tyre në komunitet. Ky bashkëpunim do të ishte me një rëndësi të madhe sidomos për trajtimin e të miturve në prag-lirimi dhe për vazhdimësinë e trajtimit pas lirit. Duke marrë parasysh se një pjesë e mirë e të miturve të përfshirë në akte delinkuente kanë pak ose aspak mbështetje nga familjarët ose të afërmit, ndërhyrja e komunitetit do të ishte vendimtare në reduktimin e mundësive për relaps.

5.2 Rehabilitimi i të miturve në institucionet e kryerjes së dënimit

Për ndërtimin e programeve të trajtimit për të mitur në I.E.V.Penale funksionon një ekip multidisiplinar, ku rolin kryesor e ka psikologu. Që në momentin e ardhjes në institucion psikologu merr kontakt me të miturit dhe në periudhën e parë të qëndrimit harton një vlerësim psikologjik për secilin rast. Më pas bazuar në konkluzionet e vlerësimit ndërtohet programi i trajtimit, i cili përmban objektiva të qarta dhe të arritshme për të miturit në funksion të ndryshimeve pozitive të qëndrueshme të sjelljes.

a) *Vlerësimi psikologjik*

Qëllimi i vlerësimit psikologjik të hartuar për të miturit në këto institucione konsiston në paraqitjen e:

- Një modeli konceptual të personit të akuzuar, të veprës së kryer dhe vulnerabilitetit vetjak;
- Rekomandimin e një trajtimi sa më të përshtatshëm për personin.

Fokusi është i ndryshëm, duke nisur që nga çështje të zhvillimit të hershëm e deri në detaje të veprës penale aktuale. Baza për organizimin e këtij fokusi është vepra dhe procesi i sjelljes problematike, ku çështjet e vlerësuara janë strukturuar rreth qëllimit të të kuptuarit të rolit të faktorëve të zhvillimit, konjktiv, afektiv, social dhe të sjelljes, si dhe mënyrës se si ndërveprojnë këta faktorë.

Qëllimi përgjithshëm i vlerësimit është të paraqesë një formulim individual rasti për personin që po vlerësohet. Ky vlerësim do të japë bazat për të parë progresin e këtij individi në trajtim.

Në formën ideale, vlerësimi duhet të bëhet në disa seanca dhe duhet të përfshijë një kombimin të intervistës, vetëraportimit, instrumenteve psikometrike, intervistave me të tjerë (familjarë, të afërm), vlerësimin e përgjigjeve dhe vëzhgimeve të sjelljes. Dokumentacioni ekzistues si p.sh raporte të mëparshme psikologjike ose psikiatrike, raporte të stafit të kujdesit social në institucione të tjera (në rastet kur i mituri është transferuar nga ndonjë institucion tjetër), dokumenteve gjyqësore, dosjes penale, ndihmojnë për të krijuar kuadrin e përgjithshëm mbi profilin e të miturve. Gjithashtu

strategjitë e intervistimit ndihmojnë në vendosjen e një marrëdhënie bashkëpunimi me të miturit si dhe motivojnë ndryshimet pozitive të sjelljes.

Fushat ku mbështetet vlerësimi psikologjik përfshijnë një seri faktorësh që takohen rëndom te delikuentët e mitur dhe në veçanti në një numër çështjesh që lidhen me dhunën. Disa nga çështjet e përfshira në vlerësim lidhen drejtpërdrejtë me qëllimet e trajtimit, ndërsa disa çështje të tjera (p.sh. historia e zhvillimit) mund të jenë tregues të shkallës së rrezikut, ose të një prirjeje të natyrshme për sjelljen e dhunshme.

Vlerësimi mbi të miturit në konflikt me ligjin bazohet në:

- Historinë e mëparshme vetjake;
- Vëzhgime të sjelljes gjatë periudhës së qëndrimit në institucion;
- Konkluzione nga kontaktet e marra me personin;
- Shënime të një hospitalizimi të mundshëm;
- Siptoma të gjendjes aktuale.

Për të kuptuar lidhjen midis personit dhe veprës penale të kryer realizohet:

- Vlerësim i tërësisë së akteve të kryera;
- Marrëdhëniet dhe pozicionet e bashkëpunëtorëve, nëse vepra është kryer në grup;
- Motivet dhe qëllimet e përfshira në veprim.

Ky informacion do të identifikojë situata me rrezik të lartë fizik dhe emocional. Historikisht, motivet që qëndrojnë në bazë të sjelljeve penale të dhunshme janë klasifikuar si: ekspresive dhe instrumentale. Në të vërtetë të dy motivet mund të veprojnë në të njëjtën kohë. Dhuna instrumentale duke mos qenë e lidhur me nxitje afektive (zemërim, eksitim, frikë) mund të jetë karakteristike e personave psikopatë. Me rëndësi janë qëndrimet e autorit pas kryerjes së veprës penale. Këto qëndrime variojnë që nga vetëkënaqësia deri te dëshpërimi dhe gjendja e shokut.

Në këtë kontekst, vlerësimi mund të zbulojë më shumë informacion rreth qëllimeve të veprës dhe marrëdhënies me sjelljen aktuale, apo nëse sjellja është ose jo konsistente me standardet e sjelljes së personit. Reagimet emocionale si pendimi, vetëpërbuzja, si dhe prirja për të bërë ndryshime për të shmangur dhunën e mëtejshme, sugjerojnë për ekzistencën e disa frenimeve të brendshme ndaj sjelljes së

dhunshme, ndërsa kënaqësia dhe gjendje të tjera shpirtërore pozitive mund të sugjerojnë se dhuna është tipar i personalitetit të personit.

Tabela 15. Qëndrimet ndaj veprës/ave penale

Qëndrimet ndaj veprës/ave penale	Po	Jo	Nuk e di
Mohon/minimizon seriozitetin e sjelljes së tij	8	64	0
Nguron të pranojë përgjegjësitë për veprën/at që ka kryer	13	59	0
Nuk kupton efektet e sjelljes së tij te viktimat	13	53	1
Beson se disa lloje krimesh janë të pranueshme dhe jot ë dënueshme	29	39	4
Beson se disa njerëz/grupe janë shënjestra të veprave kriminale	7	48	6
Beson se përfshirja në vepra penale në të ardhmen është e paevitueshme	7	56	7

Si përfundim, një vlerësim psikologjik i të miturve në institucionet penitenciare mund të japë informacion për mundësinë që një individ të përfshihet në një sjellje të caktuar. Ekziston një rregullsi dhe vazhdimësi në sjelljen e personave dhe një lidhje midis personalitetit dhe sjelljes. Ndonëse nuk ka një profil të përcaktuar të personalitetit të të miturve delinkuentë ekzistojnë disa karakterisika të përbashkëta të tyre si impulsiviteti, mungesa e stabilitetit, vetëvlerësimi i ulët dhe aftësi të kufizuara sociale.

b) *Programet e trajtimit*

Nga intervistat e marra me personat përgjegjës për kujdesin social në institucionet penitenciare, mësohet se për procesin e rehabilitimit punohet me programe individuale trajtimi, të cilat konceptohen duke marrë parasysh konkluzionet e vlerësimit psikologjik. Këto programe përmbajnë:

- Ofrimin e asistencës psikologjike;
- Ofrimin e kurseve formale të formimit profesional;
- Ofrimin e kurseve të arsimimit për të miturit analfabetë;
- Përfshirje në aktivitete në grup, (sportive; edukative; argëtuese, etj.);
- Terapi okupacionale;
- Trainim për zëvendësimin e agresivitetit;

Tabela 16. Plani i trajtimit për të miturit në I.E.V.Penale

Objektivat	Fushat e ndërhyrjes
------------	---------------------

Të miturit në konflikt me ligjin: Analizë e faktorëve të riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve

<ol style="list-style-type: none"> 1. Përmirësimi i sjelljes; 2. Përirësimi i aftësive ndërpersonale; 3. Përmirësimi i aftësive për tu përballur me problemet; 4. Ushtrimi në: <ul style="list-style-type: none"> - <i>Aftësi sociale;</i> - <i>Menaxhim zemërimi;</i> - <i>Menaxhim emocionesh</i> 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Akademike; 2. Kulturore; 3. Profesionale; 4. Sportive; 5. Të punësimit; <p><i>Ndërhyrje specifike në programin për zëvendësimin e agresivitetit.</i></p>
---	---

Interesant është aplikimi së fundi i trainimit për zëvendësimin e agresivitetit (ART), i cili përbën një risi që ka sjellë ndryshime pozitive në sjelljen e të miturve në këto institucione. Teknikat e ART-së konsistojnë në:

- Të mësuarit e aftësive sociale;
- Menaxhimin e zemërimit;
- Arsyetimin moral.

Autori kryesor i ART është Arnold P. Goldstein. Programi bazë zhvillohet në 10 javë me një frekuencë prej 3 seancash në javë (gjithsej 30 seanca). Çdo seancë zgjat përafërsisht 45 -50 minuta, përveç seancave në lidhje me dilemat morale të cilat mund të zgjasin 60 deri në 75 minuta.

Dhjetë aftësitë sociale të përzgjedhura vërtetuan se ishin mjaft të përshtatshme në 2 qëndrat e riedukimit për të rinjtë në konflikt me ligjin ku u zbatua për herë të parë ky program⁴⁶.

Kontrolli i zemërimit bazohet në programin e Feindler (Feindler & Ecton, 1986) dhe është përshtatur nga krijuesit e ART. Teknika e arsyetimit moral përdoret me situatat e zhvilluara nga Gibbs, Potter & Goldstein.

ART është një nga programet që aktualisht përdoret më së shumti në sistemin penitenciar në shumë vende të botës. Sipas autorëve, përfshirja në këtë program të shumë teknikave apo nënprogrameve është e nevojshme pasi si aftësitë sociale ashtu dhe kontrolli i zemërimit të ndarë mund të japin rezultate në plan afatshkurtër, por asnjëri prej tyre veçmas nuk ka dhënë rezultate në plan aftgjatë. Arsyetimi moral nga ana tjetër ndikon në formimin e vlerave dhe si rrjedhim ndërthurja e këtyre tri

⁴⁶ Goldstein, A.P.& Glick, B. "Aggression Replacement Training", 1987.

teknikave mund të na japë rezultate më të qëndrueshme në kohë dhe më pozitive sesa secila prej tyre e aplikuar më vete⁴⁷.

Siç dihet, sjellja agresive është e vështirë për t'u ndryshuar pasi të miturit e mësojnë atë nëpërmjet modeleve të rëndësishëm si dhe marrin përfundime pozitive prej saj. ART është një program ndërhyrjeje i konceptuar për t'iu mësuar atyre të zëvendësojnë agresivitetin dhe sjelljen antisociale me alternativa më të përshtatshme. Sipas autorëve të ART, agresiviteti është sjellje e mësuar nëpërmjet vëzhgimit, imitimit, përvojës së drejtpërdrejtë dhe të provuarit⁴⁸.

Gjithësesi zhvillimi i ndërhyrjeve efektive të të miturit/ të rinjtë e dhunshëm është një proces që nuk përfundon kurrë⁴⁹.

Agresioni nis zakonisht si efekt i praktikave edukative represive të përdorura nga prindërit dhe i një mjedisi familjar të karakterizuar nga shfaqjet e irritimit dhe nga paqëndrueshmëria⁵⁰.

Subjektet e dhunshëm karakterizohen nga një mënyrë egocentrike të menduarit. Për më tepër të miturit /të rinjtë agresivë përgjithësisht i keqinterpretojnë sjelljet e të tjerëve, duke i atribuar atyre qëndrime armiqësore, gjë që rrit mundësinë për tu përfshirë në akte të dhunshme dhe për të promovuar imazhin e tyre si persona të padëshiruar.

Kjo mënyrë të menduarit karakterizohet nga shtrembërime konjitive (siç është p.sh. minimizimi), duke u nisur nga të cilat individit ul peshën apo rëndësinë e akteve të kryera dhe pasojave të këtyre akteve. Në këtë kontekst, puna për ndryshimin e mënyrës së të menduarit është një hap i rëndësishëm për të ulur gjasat që personi të shfaqë sjellje agresive.

Më poshtë do të bëhet një analizë e përmbledhur e punës që bëhet nga specialistët e sektorit të kujdesit social që punojnë drejtpërdrejt me të miturit në drejtim të aplikimit të këtyre teknikave bazuar në literaturën përkatëse.

⁴⁷ Goldstein, A.P., Glick, B. & Gibbs J.C. "Aggression Replacement Training- A comprehensive intervention for aggressive youth", 1998, f.3.

⁴⁸ Po aty, fq.35

⁴⁹ Po aty, fq.37

⁵⁰ Patterson, G.R., Reid, J.B, Jones R.R., & Conger R.E. "A social learning approach to family intervention", 1975.

a) Të mësuarit e aftësive sociale

Qëllimi i të mësuarit të aftësive sociale është aftësimi i të miturve /të rinjve për të krijuar marrëdhënie të drejta me të tjerët. Duke ndjekur punimet e Bandura-s (1973) mbi rëndësinë e modeleve për të mësuar sjellje sociale, nëpërmjet kësaj teknike procedohet në mënyrë të strukturuar për të përfituar aftësi të ndryshme.

1. Psikologu, punonjësi social, i mëson grupit një aftësi (d.m.th një sjellje efektive për të realizuar një ndërveprim social të caktuar).
2. Një pjesë e grupit e praktikon këtë aftësi përmes role playing.
3. Pjesa tjetër e grupit jep feedback-un.
4. Terapisti jep mundësinë që aftësia sociale e mësuar të ruhet në kohë dhe të përdoret në situata reale.

b) Menaxhimi i zemërimit

Nëse aftësitë sociale janë komponenti i sjelljes në ART, kontrolli i zemërimit është komponenti emocional. Qëllimi është të fitohet vetëkontroll përballë dëshirës për të dëmtuar dikë, ndaj dhe të miturve u mësohet të mos u përgjigjen provokimeve në mënyrë të dhunshme por nëpërmjet një vargu përgjigjesh që përfshijnë të kushtuarit vëmendje ndaj:

1. Nxitesve, apo ngjarjeve të jashtme që shkaktojnë zemërim.
2. Emocioneve dhe ndryshimeve fiziologjike që tregojnë se individi po përjeton zemërim.
3. Aplikimit të teknikave të ndryshme të uljes së zemërimit si marrja frymë thellë, apo përfytyrimi i pasojave që vijnë nga të reaguarit me agresivitet.
4. Rikujtuesve, (fjali vetë- udhëzuese) që subjekti i'a thotë vetëvetes.
5. Përdorimit të aftësive sociale të përshtatshme ndaj zemërimit.
6. Analizimit të vargut të mësipërm dhe aftësive të përftuara për të kontrolluar zemërimin.

Në mënyrë të përmbledhur teknika e kontrollit të zemërimit përbëhet nga disa hapa, nëpërmjet të cilave personat e përfshirë së pari duhet të kuptojnë mënyrën tipike sipas së cilës ata interpretojnë sjelljen e të tjerëve dhe të përfundojnë duke ndryshuar këtë mënyrë dhe për pasojë dhe mënyrën e të reaguarit.

c) Arsyetimi moral

Të mësuarit e arsytimit moral synon të arrijë që personi të dëshirojë të përdorë përgjigjen e përshtatshme në vend të përgjigjes agresive në situata të caktuara. Kjo implikon formimin e vlerave morale, për shkak të të cilave individit do të preferojë veprimtarinë prosociale kundrejt asaj antisociale.

Është e rëndësishme që personi të dëshirojë të veprojë në mënyrë shoqërisht të pranueshme pasi siç dihet edhe pse një person mund të gjykojë në mënyrë korrekte nga pikëpamja morale, mund të vendosë të veprojë në mënyrë egocentrike apo antisociale.

Çështje që lidhen me aplikimin e ART

Kriter për përfshirjen në këtë program janë problemet që shfaq grupi i synuar në fushat e objektit të ndërhyrjes: aftësi sociale, kontrolli i zemërimit dhe arsytimi moral. Programi zhvillohet në grupe me 6-8 persona, ndonëse numri mund të jetë më i ulët në rastet e vështira për t'u menaxhuar.

Të miturit motivohen për t'u përfshirë në program duke i'u shpjeguar qëllimin e programit, fazat nëpërmjet të cilave zhvillohet programi dhe ajo çka mund të përfitojnë duke qënë pjesë e programit. Paraprakisht, grupi vendos disa rregulla funksionimi të drejtuara dhe orientuara nga personi që e drejton. Këto rregulla mund të prekin çështje si asistenca, pjesëmarrja, konfidencialiteti mbi diskutimet në grup, menaxhimi i konflikteve etj.

Çështje për t'u konsideruar

Pavarësisht nga përfitimet e përfshirjes së të miturve në konflikt me ligjin në programe të dobishme për përmirësimin e jetës së tyre pas lirimit, duhet konsideruar fakti që në të mësuarin e aftësive të ndryshme në kontekstin e institucioneve të mbyllura, (siç janë institucionet penitenciare), e rëndësishme është që ajo që mësohet "të ruhet", pra të jetë e qëndrueshme në kohë si dhe të përdoret në kontekste të tjera dhe për këtë i duhet kushtuar rëndësi përforsimit të sjelljeve pozitive.

Njëkohësisht është e rëndësishme përgatitja e pjesëmarrësve për mungesën e përforsimit në ambientin natyror. Një strategji për të favorizuar ruajtjen është përdorimi i përforsuesve që ekzistojnë në mjedisin social të të miturve të përfshirë

në program, si dhe përgatitja e tyre për të qënë të vëmendshëm ndaj fakteve që dëshmojnë përmirësimin e disa aspekteve të jetës së tyre.

Me rëndësi të veçantë është krijimi i një klime të sigurtë në institucione në mungesë të së cilës, ART ashtu si çdo program tjetër mund të mos rezultojë i suksesshëm.

Rezultatet e studimit

Në përfundim të studimit konkludojmë se:

- Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri bazuar në statistikat ekzistuese ka ardhur në rritje sidomos gjatë 5 viteve të fundit.
- Të miturit në konflikt me ligjin në Shqipëri janë kryesisht meshkuj. Gjatë periudhës së intervistimit nuk rezultonte asnjë e mitur femër e akuzuar apo e dënuar për kryerjen e veprave penale.
- Në përgjithësi të miturit e akuzuar, apo të dënuar për kryerjen e veprave penale janë pak të arsimuar, apo të kualifikuar profesionalisht.
- Vepra penale për të cilën janë akuzuar, apo dënuar më së shumti të miturit është ajo e vledhjes në forma të ndryshme.
- Është rritur numri i të miturve të përfshirë në vepra penale që kanë të bëjnë me prodhimin dhe shitjen e lëndëve narkotike.
- Të miturit në konflikt me ligjin kanë disa karakteristika të përbashkëta si, mohim apo mosbesim ndaj autoriteteve, vetëkontroll i pakët, stil konjitiv impulsiv, dhe mungesë aftësie në menaxhimin e konflikteve.
- Përgjithësisht të miturit në konflikt me ligjin vijnë nga familje me problematika të mprehta socio-ekonomike.
- Një pjesë e konsiderueshme e të miturve në konflikt me ligjin vijnë nga familje që janë zhvendosur nga zona rurale në zona urbane/suburbane dhe që kanë pasur vështirësi për t'u integruar ekonomikisht dhe kulturallisht.
- Një pjesë e të miturve që kanë kryer vepra penale, kthehen në recidivistë.

Përfundime dhe rekomandime

Ky studim mbi të miturit në konflikt me ligjin, synoi që përveç evidentimit të faktorëve psiko-socialë të riskut dhe përshkrimit të profileve të të miturve, të formulojë dhe disa konkluzione të përgjithshme mbi rezultatet e studimit të cilat do të ishin me interes për të gjithë subjektet e interesuara për këtë kategori dhe veçanërisht për hartimin e politikave të parandalimit të kriminalitetit dhe rehabilitimit të të miturve që janë përfshirë në kryerjen e veprave penale. Studimi mund të konsiderohet përshkrues, pasi paraqet gjendjen reale të të miturve në disa nivele.

Bazuar në rezultatet e këtij studimi mund të thuhet se kriminaliteti i të miturve në Shqipëri ka qenë dhe mbetet një problem shqetësues për shoqërinë shqiptare. Shifrat që rriten nga viti në vit sidomos gjatë 5 vjeçarit të fundit e dëshmojnë këtë.

Fakti që pothuajse të gjithë të miturit për periudhën e studiuar rezultojnë të jenë meshkuj, tregon se meshkujt ka më shumë gjasa të përfshihen në kryerjen e veprave penale. Ky rezultat mund të vijë si pasojë e disa faktorëve siç janë, mungesa e supervizionit prindëror, terreni më favorizues për t'u përfshirë në sjellje të tilla, personalitet më agresiv, apo tendencë më e madhe për të eksperimentuar sjellje me rrezikshmëri.

Fakti që pjesa më e madhe e të miturve janë akuzuar apo dënuar për kryerjen e veprës penale të vjedhjes në forma të ndryshme, është në përputhje me faktorë të tjerë si gjendja e vështirë ekonomike, mungesa e arsimimit apo formimit profesional. Të gjithë këta faktorë bëjnë që të miturit të mos kenë zgjedhje dhe të mundohen për të siguruar burime mbijetese në mënyrë të jashtëligjshme.

Përsa i përket rritjes së të miturve të përfshirë në vepra penale që kanë të bëjnë me prodhimin dhe shitjen e lëndëve narkotike, apo rritjes së numrit të të miturve përdorues të drogave (kryesisht drogave të lehta) është një tregues shqetësues për shoqërinë. M.gj.th mungojnë statistikat lidhur me këtë çështje si dhe statistikat krahasuese për kategorinë e të rriturve.

Lidhur me disa karakteristika të veçanta të personalitetit dhe sjelljes, që vihen re te të miturit në konflikt me ligjin mund të thuhet se këto rezultate vijnë si pasojë e vëzhgimeve të sjelljes dhe të dokumentacionit personal të të burgosurve, si dhe nga intervistat e kryera me punonjësit e sektorëve socialë që punojnë drejtpërdrejt me ta. Këto rezultate vërtetojnë rëndësinë e faktorëve individualë të riskut dhe përputhen me literaturën e fushës.

Fakti që të miturit vijnë nga familje me probleme të mprehta socio-ekonomike mbështet rezultatet e studimeve të kryera më parë, të cilët vënë theksin tek faktorët familjarë të riskut që ndikojnë në rritjen e kriminalitetit të të miturve.

Nga ana tjetër vihet re se migrimi në mënyrë të çorganizuar dhe problemet kulturore dhe ekonomike si pasojë e tij kanë krijuar një mjedis jostabël për të miturit, që reflektohet në rritjen e kriminalitetit për këtë kategori.

Fakti që një pjesë e të miturve kthehen në recidivistë pavarësisht nga puna rehabilituese e kryer në institucionet penitenciare, është tregues i qëndrueshmërisë së faktorëve të riskut "në mjedisin natyror" si dhe i mungesës apo pamjaftueshmërisë së strukturave që punojnë për integrimin e tyre pas lirimt.

Përsa i përket faktorëve të riskut që ndikojnë në përfshirjen e të miturve në akte kriminale, rezulton se roli i faktorëve individualë, familjarë, apo komunitarë është i ndjeshëm në sjelljen e të miturve, ashtu siç referohet dhe nga studime të mëparshme të fushës, të cilat janë sjellë përmes literaturës së përzgjedhur.

Informacioni kryesor që ofron ky studim, është fakti se sipas statistikave kriminaliteti i të miturve në Shqipëri ka ardhur vazhdimisht në rritje. Bazuar në këto të dhëna duhet konsideruar me seriozitet nevoja për ndërtimin e programeve efikase të parandalimit, të cilat duhet të synojnë përfshirjen jo vetëm të të miturve në konflikt e ligjin, por të të gjithë të miturve që janë veçanërisht të ekspozuar ndaj faktorëve të riskut.

Një element shumë pozitiv është hartimi dhe zbatimi i programeve rehabilituese të të miturve në institucionet penitenciare. Megjithatë, këto programe nuk mund të sjellin ndryshime të qëndrueshme në përmirësimin e sjelljes së të miturve, nëse nuk reduktohen faktorët e riskut si dhe nëse nuk ekzistojnë struktura që ofrojnë programe ri-integruese për periudhën pas lirimt.

Duke konsideruar sa më sipër, sugjerojmë që subjektet/strukturat që do të interesohen në të ardhmen për realizimin e studimeve në këtë fushë të hulumtojnë në disa nivele (shkollë, familje, komunitet), me qëllim eksplorimin e fenomenit në të gjitha dimensionet.

Bibliografia

Bandura, A. "Aggression: A social learning analysis", 1973.

Brewer, D.D., Hawkins, J.D., Catalano R.F., and Neckerman, H.J., *Preventing serious, violent and chronic juvenile offending: A review of evaluations of select strategies in childhood, adolescence and the community*, 1995.

Catalano R.F., and Hawkins, J.D., *The social development model: A theory of antisocial behavior. In delinquency and crime: Current Theories*, edited by J.D.Hawkins, New York, Cambridge University Press, 1996.

Child Delinquency, Bulletin Series, U.S Department of Justice, Office of Justice Programs, Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention, 2003.

Conseur, A., Rivara, F.O., Barnowsky, R., and Emmanuel, I., "Maternal and perinatal risk factors for later delinquency", 1997.

Costello, E.J., Farmer, E.M., Angold, A. Burns, B., and Erkanli, A., "Psychiatric disorders among American Indian and White youth in Appalachia: The great Smoky Mountains Study". *American Journal of Public Health*, 1997.

Developmental Research and Programs; Promising Approaches to Prevent Adolescent Problem Behaviors. Seattle WA: Developmental Research and Programs, 1996.

Winnicott, D.W, *Deprivation and delinquency*, 1984, www.routledge.com

Farrington, D.P., "The development of offending and antisocial behavior from childhood: Key findings from the Cambridge Study in Delinquent Development." *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 1995

Farrington, D.P., Barnes, G.C., and Lambert, S., "The concentration of offending in families". *Legal and Criminological Psychology*, 1996.

Farrington, D.P., "Predictors, causes and correlates of male youth violence", *In youth violence*, vol.24, edited by M. Tonry and M.H. Moore. Chicago I.L: University of Chicago Press, 1998.

Feindler, E.L & Ecton, R.B., "Adolescent Anger Control", 1986.

Fergusson, D.M., and Horwood, L.J., "Early disruptive behavior IQ, and later school achievement and delinquent behavior" *Journal of Abnormal Child Psychology*, 1995.

Gardner, F.E.M., "Positive interaction between mothers and conduct-problem children: Is there training for harmony as well as fighting?", *Journal of Abnormal Child Psychology*, 1987.

Goldstein, A.P. & Glick, B. "Aggression Replacement Training", 1987.

Goldstein, A.P., Glick, B. & Gibbs J.C. "Aggression Replacement Training- A comprehensive intervention for aggressive youth", 1998.

Guttentag, M., Salasin, S., and Belle, D., "The mental Health of Women", New York, Academic Press, 1980.

Haapasalo, J., and Trambly, R.E., "Physically aggressive boys from age 6 to 12: Family background, parenting behavior and prediction of delinquency". *Journal of Consulting and Clinical Psychology*, 1994.

Hawkins, J.D., Herrenkohl, T., Farrington, D.P., Brewer, D., Catalano, R.F., and Harachi, T.W. "A review of predictors of youth violence in serious and Violent Juvenile Offenders" *Risk Factors and Successful Interventions*, Edited by R. Loeber and D.P Farrington. Thousand Oaks, C.A: Sage Publications, Inc., 1998.

Hetherington, E.M., "Coping with family transitions: winners, losers and survivors. *Child Development*", 1989.

Howell, J.C., *Youth Gangs: An Overview Bulletin*, Washington D.C., U.S., Department of Justice, Office of Justice Programs, Office of Juvenal Justice and Delinquency Prevention, 1998.

Hughes H.M., Parkinson, D., and Vargo, M., "Witnessing spouse abuse and experiencing physical abuse", *Journal of Family Violence*, 1989.

Hysi, V., *Cikël leksionesh*, Tiranë, 2000.

Kriminaliteti i të Miturve në Shqipëri, përgatitur nga Qendra për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), Tiranë, 2007.

Lahey, B.B., Piacentini, J.C., Mc Burnett, K., Stone, P., Hartdagen, S., and Hynd, G., "Psychopathology in the parents of children with conduct disorder and hyperactivity", *Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 1988.

Le Blanc, M., Cote, G., and Loeber, R., "Temporal paths in delinquency: Stability, regression and progression analyzed with panel data from an adolescent and delinquent sample", *Canadian Journal of Criminology*, 1991.

Lewis, D.O., Mallouh, C., and Webb, J., "Child abuse, delinquency, and violent criminality". *Theory and research on the Causes and Consequences of Child Abuse and Neglect*, edited by D.Cicchetti and V.Carlson, New York, Cambridge University Press, 1989

Loeber, R., Green, S.M., Keenan, K., and Lahey, B.B., "Which boys will fare worse? Early predictors of the onset of conduct disorder in a six year longitudinal study" *Journal of American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 1995.

Loeber, R., and Farrington, D.P., "Child Delinquents: Development, Intervention and Service Needs". Thousand Oaks, CA: SAGE Publications, Inc., 2001.

McKibben, L., De Vos, E., and New Berger, E., "Victimization of mothers of abused children: A controlled study", 1989.

Moffit, T.E., "The neuropsychology of conduct disorder" *Development and psychopathology*, 1993.

Newman, D.J., and Anderson P.R., "Introduction to Criminal Justice", New York, 1990.

Patterson, G.R., Reid, J.B, Jones R.R., & Conger R.E. "A social learning approach to family intervention", 1975.

Patterson, G.R., Crosby,L., and Vulchinich, S. "Predicting risk for early police arrest. *Journal of Quantitative Criminology*", 1992.

Pearson, J.L., Ialongo, H.S., Hunter, A.G., and Kellum, S.G., "Family Structure and Aggressive behavior in a population of urban elementary school children", *Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 1994.

Reid, W.J., and Crisafulli, A., "Marital discord and child behavior problems: A meta analysis", *Journal of Abnormal Child Psychology*, 1990.

R. Loeber & D.P. Farrington, eds 2001. *Child Delinquents: Development, Intervention and Service Needs*. Thousand Oaks, CA: SAGE Publications, Inc. Robins, L.N., "Deviant Children Grow Up", Baltimore, MD. Williams and Wilkins, 1966.

Rutter, M., Giller, H., and Hagell, A., "Antisocial Behavior by Young People", New York, Cambridge University Press, 1998.

Strategjia Kombëtare për Fëmijë dhe Plani i Veprimit 2005-2010, përgatitur nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta; Mars 2010.

Shaw, C.T., and McKay, H.D., *Report and Causes of Crime, vol.2*, Washington, DC: U.S Government Printing Office, 1931.

Shëndeti Mendor dhe të Drejtat e Njeriut, Botim i Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës, Vol.3, 2004.

Tremblay, R.E., Pihl, R.O., Vitaro, F., and Dobkin, P.L., "Predicting early onset of male antisocial behavior from preschool behavior". Archive of General Psychiatry, 1994.

Wasserman, G.A., Miller, L., Pinner, E., and Jaramillo, B.S., "Parenting predictors of early conduct problems in urban, high-risk boys." Journal of American Academy of Child and Adolescent Psychiatry., 1996.

West, D.J., and Farrington, D.P., "Who became delinquent?", London, England, 1973.

White, J.L., Moffitt, T.E., Earls, F., Robins, L., and Silva P.A., "How early can we tell? Predictors of childhood conduct disorder and delinquency. Criminology, 1990.

Widom, C.S., "The cycle of violence Science", 1989.

Zuckerman, B., Augustyn, M., Groves, B.M., and Parker, S., "Silent victim revisited: the special case of domestic violence", 1995.